

1 E martë, 28 janar 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është lënda KSC-BC-
8 2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri
9 Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pikësëpari,
11 Sekretarja kishte për të bërë një korrigjim të një numri të
12 provës që është pranuar dje?

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po. Dje kur pranua
14 provën P02009, ERN që na u dha ishte 124938-124951. Por në
15 fakt, nuk ka qenë numri i saktë, sepse numri i saktë është
16 124938-124958. Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Vërej që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
19 sallën e gjyqit.

20 Përpara se të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
21 Prokurorisë W04743, ka disa aspekte paraprake që Trupi Gjykses
22 dëshiron të trajtojë.

23 Trupi Gjykses vëren se me një email më 23 janar 2025,
24 ZPS-ja njoftoi Trupi Gjykses, palët dhe pjesëmarrësit se, në
25 paketën e materialeve 1558, ka nxjerrë përkthimet në anglisht

1 të materialeve 043853-043854-ET, të cilat u pranuan dhe morën
2 numrin e provës P00851-ET dhe SPOE00230134 deri në
3 SPOE00230134-ET. ZPS-ja parashtroi se kjo ishte për shkak se
4 kishte mospërputhshmëri përkthimesh mes dy materialeve
5 pjesërisht.

6 ZPS-ja, më 27 janar 2025, kërkoi që prova që kishte marrë
7 numrin P00851-ET të zëvendësohej me një version tjetër të
8 rishikuar të përkthimit që kishte numrin ERN 043853-043854-ET
9 *Revised*.

10 Ka ndonjë koment nga ekipet e Mbrojtjes lidhur me këtë?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, s'kemi asnjë kundërshtim.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Atëherë e miratojmë kërkesën dhe udhëzon Sekretarinë që
14 të zëvendësojë materialin përkatës P00851-ET me 043853-043854-
15 ET *Revised*.

16 Me këtë mbyll urdhrin me gojë.

17 I lutem Sekretares së seancës të na kalojë në seancë
18 private.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më tej, të
3 premtën më 24 janar 2025, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë sipas
4 rregullës 154, përkatësisht 02860, ishte një kërkesë për
5 dëshmimin përmes videolidhjes për Dëshmitarin W00542. Siç u
6 shprehën dhe në email të hënën më 27 janar 2025, Trupi Gjykses
7 kërkon parashtrime me gojë lidhur me kërkesën F02860, nëse ka
8 ndonjë përgjigje.

9 Mbrojtësi i Viktimave, ka diçka për të thënë lidhur me
10 këtë?

11 Z. LAWS: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ekipet e
13 Mbrojtjes kanë diçka për të thënë?

14 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Në emër të Mbrojtjes
15 së z. Veseli, nuk kemi kundërshtim as për kërkesën sipas
16 rregullës 154 dhe as për kërkesën për dëshmi përmes
17 videolidhjes. Sidoqoftë duam ta bëjmë të qartë për
18 procesverbal, nuk mendojmë që janë përmbushur pragjet
19 sidoqoftë sa u takon këtyre kërkesave. Por, duke marrë
20 parasysh përshpejtimin e procesit gjyqësor dhe rëndësinë e
21 dëshmitarit, mesa kuptojmë ne, ky është një dëshmitar që
22 fillon më 10 shkurt, apo jo, përpara se të vijë dëshmitari që
23 është, që do të kërkojë edhe më shumë kohë se të tjerët.

24 Prandaj nuk kemi kundërshtim që të fillojë ky dëshmitar
25 në ditën që ishte caktuar dhe i lutem Prokurorisë të na

1 njoftojë nëse do të ketë dëshmitarë të tjerë të kësaj natyre
2 në mënyrë që të jemi të përgatitur për dëshmitarin e
3 rëndësishëm i cili do të kërkojë shumë kohë, të jemi të
4 përgatitur.

5 Kështu që ju lutem nëse ka ndonjë dëshmitar tjetër të
6 kësaj natyre, të na njoftojnë që të përgatitemi. Pra, ju thamë
7 edhe një herë nuk kemi asnjë kundërshtim. Le të vazhdojmë në
8 mënyrën siç është kërkuar nga Prokuroria.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ekipi i Mbrojtjes së Thaçit
10 bashkohet me parafolësin.

11 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe ne pajtohemi.

12 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Edhe ne pajtohemi.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Ja lëmë në dorë Prokurorisë të vendosë. Por, ju lutem, sidomos
15 për dëshmitarët shumë të rëndësishëm dhe kaq të mëdhenj, është
16 mirë që shënimet përgatitore të jepen në kohë të mjaftueshme
17 paraprakisht që t'ju japim mundësi ekipeve të Mbrojtjes të
18 përgatiten dhe të mos kemi vonesa për shkak të kësaj.

19 Do të nxjerrim vendim lidhur me këtë në kohën e duhur.

20 Vazhdojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë
21 W04743.

22 Ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

23 Znj. Prokurore, edhe sa kohë mendoni se ju nevojitet?

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do t'i përditësoj momentin e
25 duhur, por do përpiqem që të qëndrojë brenda tre orarëshit që

1 kisha kërkuar.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
4 uleni, Dëshmitar.

5 Vërej për procesverbal që Avokati Kujdestar për
6 Dëshmitarin 04743 është i disponueshëm jashtë sallës së
7 gjyqit, në rast se dëshmitari ka nevojë për këshilla.

8 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

9 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do
11 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju rikujtoj të përgjigjeni qartë
12 me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht
13 kërkonit që pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni që
14 ta sqarojmë. Gjithashtu mos harroni të na thoni ku i bazoni
15 njohurinë për faktet dhe për rrethanat për të cilat do t'ju
16 bëjnë pyetje.

17 Ju rikujtoj se jeni ende, keni ende detyrimin për të
18 thënë të vërtetën sikurse vetë e thatë përmes betimit solemn.
19 Ju rikujtoj po ashtu që garancitë që ju dha Trupi Gjykses
20 përkatësisht që nuk do të ndiqeni penalisht drejtpërdrejt apo
21 tërthorazi për dëshminë që do të jepni në sallën e gjyqit as
22 nga Dhomat e Specializuara, as nga Prokuroria me përjashtim të
23 rasteve që parashihen në nenin 15(2) të ligjit dhe rregullës
24 65 dhe se refuzimi për të dhënë dëshmi mund të sanksionohet me
25 gjobë.

1 Prisni pesë sekonda përpara se të përgjigjeni, flisni
2 pranë mikrofonit.

3 Edhe, një herë, nëse keni nevojë për pushime, në çdo
4 moment ngrini dorën dhe do bëjmë organizimin tonë.

5 Vazhdojmë tani me pyetjet e Prokurorisë. Ju lutem
6 dëgjojini me vëmendje.

7 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

8 DËSHMITARI: NASER KRASNIQI [Vijon]

9 Pyetje nga znj. Iodice: [Vazhdon]

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

11 PY. Mirëmëngjesi, z. Krasniqi.

12 Dje po flisnim për detyrat që keni pasur ju në Brigadën
13 121.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
15 ekran materialin 124959 deri në 124990 dhe shkojmë në faqen
16 PDF 31, që ka ERN 124989.

17 PY. Z. Krasniqi, a ju kujtohet që javën e kaluar ia keni
18 dhënë ju Prokurorisë këtë dokument?

19 PË. Po.

20 PY. Si e keni gjetur ju këtë dokument?

21 PË. Ky dokument është përpiluar gjatë kohës së luftës,
22 përkatësisht në muajin janar 1999. Dhe për një kohë nuk e kam
23 dit ku e kam, mirëpo rastësisht e kam gjetur me disa dokumente
24 të mia personale.

25 PY. Faleminderit.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E zmadhojmë pak, ju lutem që të
2 shohim qartë shqipen. Shkojmë poshtë tek nënshkrimi.

3 PY. A e njihni nënshkrimin tuaj këtu, z. Krasniqi?

4 PË. Po, patjetër. Është emri dhe mbiemri im të cilin e kam
5 shkruar vetë personalisht.

6 PY. Pra, e keni përpiluar ju këtë dokument?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. Faleminderit.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim paragrafin e parë ose
10 pjesën e sipërme të faqes.

11 PY. Në paragraf thuhet, pra keni shkruar këto fletë-denoncim
12 se dy policët nuk kanë përmbushur detyrat që ka nxjerrë
13 drejtorja për financat pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
14 së, përkatësisht me numër 90/III, data 31 dhjetor 1998, mbi
15 përcaktimin e obligimit për qytetarët e Kosovës për kohësisht
16 të punësuar në botën e jashtme.

17 Çfarë donte të thoshte ky vendim, për çfarë ishte ky
18 vendim në fjalë, për çfarë ishte ky vendimi pra?

19 PË. Ashtu qysh shihet dhe na paragrafi i parë i kësaj
20 shkrese, kishte të bënte me inkasimin e të hyrave për Luftën
21 Çlirimtare në Kosovë për mërgimtarët, të cilët nuk kishin
22 financuar në botën e jashtme, përkatësisht nuk i kishin shlyer
23 obligimet atje, andaj na ishte dhënë detyrë që t'i verifikonim
24 dhe këto obligime t'i shlyenin në vend, do të thotë, në
25 Kosovë. Po flas çdoherë për territorin e Brigadës 121,

1 përkatësisht të togut të policisë ushtarake të Brigadës 121.

2 PY. Faleminderit. Sa ka qenë shumë e kontributeve, si ndahej
3 kjo shumë kontributesh, a e dini këtë?

4 PË. Shuma e kontributeve ishte sipas shteteve. Të gjitha
5 ishin të specifikuara -- më falni, ishin të specifikuara në
6 atë vendim. Kjo varet nga shtetet dhe varionte nga 1.000 deri
7 në 2.000 marka apo franga zvicerane.

8 PY. Çfarë ndodhte nëse dikush nuk e kryente këtë pagesë?

9 PË. Sipas detyrave që ishin të dhëna, në qoftë se mërgimtarët
10 nuk i kishin kryer këto obligime dhe nuk -- në këtë rast në
11 Kosovë do të duhej t'i merrej pasaporta derisa t'i shlyente
12 obligimet.

13 PY. Faleminderit. A ju kujtohet nëse e keni marrë ju këtë
14 vendim të Shtabit të Përgjithshëm?

15 PË. Ne, si togë e policisë ushtarake, vendimin e kemi marrur
16 nga brigada, respektivisht nga komandanti i brigadës, z.
17 Shala.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim dokumentin në dy
19 paragrafët e fundit.

20 PY. Pjesa e dokumentit ku ka një shënim që thatë se:

21 "Ne mendojmë se funksionimi i LDK-së dhe kuvendit të saj
22 është shkaku kryesor i ngecjes së punës tonë në këtë fshat."

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj. I nderuar
24 Kryegjykatës, nuk e di a duhet të kalojmë në seancë private
25 për këtë por mbase duhet të largohet dhe dëshmitari nga salla

1 e gjyqit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës ju lutem.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon kësaj, ne kemi bërë

6 parashtrime për këtë dhe, ju e dini dhe kemi pasur

7 kundërshtime për përdorimin e këtij dokumenti. Prokuroria dje

8 na dha një sqarim për çfarë do ta përdornin këtë dokument. Kjo

9 është shprehur në transkript faqja 12, thanë:

10 "Dokumenti i fundit është një dokument i janarit 1999,

11 është një ankesë, është me një letër me kokë e nënshkruar nga

12 4743 që ka të bëjë me masat disiplinore lidhur me oficerë të

13 policisë ushtarake të 121-shit. Dhe, sidoqoftë, po diskutohet

14 gjatë e gjerë tashmë ky dokument dhe Trupi Gjykses mori një

15 vendim lidhur me këtë në faqen 96 të transkriptit, rreshti 24

16 dhe ju thatë:

17 "Ndonëse Mbrojtja nuk ka qenë e njoftuar konkretisht për

18 këtë dokument, Trupi Gjykses pajtohet me ZPS-në se ka qenë më

19 së paku e njoftuar sa i takon rolit që ka pasur Dëshmitari

20 04743 dëshmitari në UÇK dhe do të flasë për strukturën dhe

21 rolin që ka pasur ai me 121-shin."

22 Tani unë nuk do kisha kundërshtuar, po me ç'po shohim ne,

23 ky dokument nuk ka fare lidhje me masat disiplinore edhe

24 cenimi që është për ne është që nuk është përmendur fare në

25 dosjen paraprahe gjyqësore këtu është përmendur një fshat me

1 emrin Bllaca, në të cilin ka ndodhur një incident. Nuk është
2 përmendur asnjëherë fakti që LDK-ja paska qenë problematike në
3 këtë fshat. Të gjitha këto janë aspekte që ne do t'i kishim
4 hetuar përpara këtë fshat, do ta kishim intervistuar personin
5 përpara se të fillonim kundërpyetjet dhe ne po cenohemi sepse
6 Prokuroria po trajton një fushë që dje na tha që nuk do ta
7 trajtonte.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
11 kundërshtimi. Për ne është një aspekt relevant dhe do të
12 dëgjojmë dëshminë që ka personi lidhur me këtë.

13 Sikurse ju thashë dhe dje, ju mund të kërkoni --

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] -- që ta
16 thërrasim prapë dëshmitarin, pra, bëni hetimet tuaja dhe e
17 thërrasim prapë dëshmitarin të vijë.

18 Mirë. Vazhdoni, znj. Prokurore.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

20 PY. Z. Dëshmitar, unë po ju tregojta pjesën e fundit të
21 dokumentit ku ju keni thënë se funksionimi i LDK-së dhe
22 kuvendit të saj është shkaku kryesor i ngecjes së punës suaj
23 në këtë fshat, pra, në fshatin Bllacë bëhet fjalë. A mund të
24 na tregoni pse paska qenë problem funksionimi i LDK-së dhe
25 kuvendit të saj? Çfarë keni dash të thoni ju këtu në nëntekst?

1 PË. Ky është një formë e raportimit në lidhje me arsyet e
2 dështimit të zbatimit të detyrave në këtë fshat. Dhe kështu së
3 paku ishin informatat në kontekst të kohës. Kështu mendoja dhe
4 kështu e kam përpiluar shkresën për komandantin e brigadës.

5 PY. Që të jemi të qartë dhe për procesverbalin, ju keni marrë
6 informata se LDK-ja ishte pengesë për grumbullimin e parave që
7 vinin nga diaspora?

8 PË. Po, ashtu i kishim informatat atëherë.

9 PY. Faleminderit. Po keni marrë ndonjë informatë pse ishte
10 pengesë LDK-ja, çfarë bënte LDK-ja që pengonte këtë zbatim?

11 PË. Nuk mund të jem më specifik sesa ajo që kam shkruar në
12 dokument apo dhe që kam deklaruar.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do kërkoja pranimin e këtij
14 dokumenti si provë gjyqësore.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
16 kundërshtime?

17 Z. DIXON: [Përkthim] Po, kemi kundërshtime. Ju lutemi
18 jepini një numër provizor fillimisht sepse sikurse u shprehët
19 dhe ju, mund të ketë nevojë që ne të bëjmë hetime dhe të
20 thërrasim sërish dëshmitarin për këtë çështje. Nuk mund të
21 shprehemi tani. Prandaj duke marrë parasysh kundërshtimet që
22 kemi ne, është më e përshtatshme të japim një numër provizor.

23 Dhe kjo është çështje shumë e rëndësishme sepse jemi në
24 një proces penal këtu dhe do të ishte mirë që të kishim dhe
25 versionin origjinal të këtij dokumenti. Nuk kam kritika me

1 dëshmitarin. Por mesa kuptoj unë, ZPS-ja s'ka kërkuar që
2 dëshmitari të japë dokumentin origjinal që është e përsëritur
3 kjo praktikë nga ana e Prokurorisë. Pse të mos kemi dokumentin
4 origjinal siç duhet të ndodhë në një gjykim normal.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Duke marrë parasysh kundërshtimin
6 që ne thamë pak më herët, sigurisht, që ne e kundërshtojmë
7 pranimin e tij dokumenti.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshmitari tha që ky është një
9 dokument i vërtetë. Flet për përmbajtjen e tij. Nuk ka ndonjë
10 detyrim nga ana jonë të kërkojmë kopjen origjinale pasi vetë
11 dëshmitari na e tregoi sesi e ka gjetur këtë dokument, sesi e
12 ka përpiluar këtë dokument dhe se është vetë autori i këtij
13 dokumenti.

14 Sa i takon kundërshtimit të z. Dixon, nuk ka nevojë për
15 numër provizor dokumenti, sepse mund ta bëni sërish hetimin.
16 Tashmë ky dokument është trajtuar. Dëshmitari ka dhënë komente
17 lidhur me këtë dokument dhe ka përmbushur kriteret e rregullës
18 138.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti do
20 të pranohet sepse përmbush kriteret minimale të rregullës 138.
21 Bëhet fjalë për dokumentin 124990-124989 -- ju doni thjesht
22 faqen 31?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, vetëm faqen 31.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
25 Faqja 31 pranohet.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqja 1249989 deri në
2 124989, që është pjesë e dokumentit që në tërësinë e vetë mban
3 numrin 124959-124990, do të marrë numrin e provës P02015. Dhe
4 ka klasifikim konfidencial.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

6 Do i kërkoja Sekretares tani të paraqesë në ekran
7 dokumentin ERN U000-5976 deri në U000-6009. Të shkojmë në
8 faqen 10 të PDF-s ë që ka numrin U000-5985.

9 PY. Z. Krasniqi, a ju kujtohet që e keni parë këtë dokument
10 gjatë seancës përgatitore përpara një jave?

11 PË. Po, gjatë seancës përgatitore më është bërë i ditur ky
12 dokument, do të thotë, e kam parë.

13 PY. Përmbajtja e këtij dokumenti a pasqyron urdhrin që keni
14 marrë juve sa i takon zbatimit dhe mbledhjes së kontributeve?

15 PË. Unë nuk e di kush e ka shkruar dokumentin, mirëpo
16 përmbajtja korrespondon me detyrat që kemi pasur.

17 PY. Faleminderit.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj që këtë faqe ta pranojmë
19 në prova gjyqësore.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
21 kundërshtim?

22 Z. DIXON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Kemi të
23 njëjtin kundërshtim që thamë dhe më përpara. Dëshmitari nuk
24 është në gjendje që të identifikojë këtë dokument. Nuk është
25 një dokument që e ka shkruar ai. Dhe ai nuk mund të thotë

1 asgjë tjetër lidhur me këtë dokument pasi dokument pretendohet
2 që të ketë ardhur nga Shtabi i Përgjithshëm.

3 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
4 dëshmitari e tha shprehimisht që nuk e di kush e ka shkruar
5 këtë dokument apo nga ku e ka origjinën, prejardhjen ky
6 dokument.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshmitar dëshmoi lidhur me
8 përmbajtjen dhe urdhrin që ka marrë për sa i takon mbledhjes
9 së detyrimeve.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitari -
11 më falni - dokumenti U000-5976 deri në U000-6009 në faqen 10
12 pranohet. Sepse përmbush kriteret minimale sipas rregullës
13 138.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
15 nderuar Gjykatës. Dhe për procesverbal numri ERN në faqen 10
16 dokumentit U000-5985 pranohet dhe do të marrë numrin e provës
17 P02016. Klasifikimi është konfidencial.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Besoj që mund ta bëjmë publik,
20 mund ta riklasifikojmë dokumentin.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë e
22 klasifikojmë si dokument publik.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshmitar, a ju kujtohet në qoftë
24 se ka pasur ndonjë rregullore të UÇK-së që kishte të bënte me
25 mbledhjen e fondeve përmes taksave apo tarifave të ndryshme?

1 PË. A mundesh me qenë më konkret, më specifike, me e
2 thjeshtësu pyetjen, të lutem?

3 PË. A ju kujtohet në qoftë se ju keni zbatuar ose kemi
4 mbledhur fonde të tjera përmes vendosjes së tarifave ose
5 taksave, ju kujtohet të keni qenë i përfshirë në ndonjë proces
6 të tillë?

7 PË. Kemi pas një detyrë për inkasimin e të hyrave për
8 automjetet të cilat kanë qenë të regjistruara tek organet e
9 okupatorit, mirëpo është tjetër çështje mandej sesa është
10 arrit me u zbatu. Por si detyrë ka qenë.

11 PY. A mund të na e shpjegoni pak në më tepër hollësi se çfarë
12 doni të thoni kur thoni që ka pasur një urdhër "për të
13 mbledhur para për regjistrimin e automjeteve"? A mund të na
14 thoni se si është zbatuar në praktikë një urdhër i tillë?

15 PË. Unë u mundova ta sqaroj në aspektin teorik sesi ka qenë
16 detyra që të gjitha automjetet që lëvizin nëpër territoret e
17 UÇK-së me tabela të sistemit të atëhershëm, do të thotë, të
18 okupatorit, është dashtë të paguajnë një tarifë 300 deri në
19 900 marka diku ka qenë. Mandej zbatimi i saj varet dikund ka
20 mund të zbatohet, diku jo, diku më shumë diku më pak. Por si
21 një detyrë e tillë ka qenë.

22 PY. Këtë detyrë a ia deleguat ose ia transferuat njësitit
23 tuaj?

24 PË. Çdo detyrë që unë kam pranuar gjithmonë dhe çdoherë e kam
25 përcjellë tek dy njësitë e mia që kanë vepru në kuadër të

1 Brigadës 121.

2 PY. A keni ju arsye për të besuar që njësitë e tuaja nuk e
3 kanë zbatuar këtë urdhër tuajin?

4 PË. Unë besoj se çdo herë i kanë zbatu ose janë munduar t'i
5 zbatojnë detyrat për aq sa kanë pasur mundësi në kontest të
6 rrethanave.

7 PY. A ju kujtohet se kush i ka nxjerrë ose kush e ka lëshuar
8 këtë rregullore që kishte të bënte me taksat për automjetet
9 ose tarifat për automjetet?

10 PË. Por edhe në këtë rast, sikurse në rastin e mëhershëm, ne
11 detyrën apo urdhrin e kemi marrur nga brigada. Kur them "ne" i
12 referohem policisë ushtarake. Mandej se ku e ka marrë brigada
13 ose në këtë rast komandanti i brigadës, më saktë e din ai.
14 Mirëpo është thirr në Shtabin e Përgjithshëm.

15 PY. Faleminderit. Tani do të kalojmë te disa prej dokumenteve
16 të cilat keni dhënë ju.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për Sekretarinë do i kërkoja që
18 të na tregojë në ekran dokumentin ERN 082926 deri në 803087.
19 Të kalojmë tek faqja që është PDF 119 me numër ERN 083044 në
20 të dyja gjuhët. Të kalojmë pak më poshtë në faqen në versionin
21 në shqip.

22 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

23 PË. Po, sigurisht.

24 PY. A e dini kush e ka nënshkruar atë?

25 PË. Po. Është nënshkrimi im.

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice (Vazhdon)

Faqe 19

1 PY. A e keni lëshuar ju këtë dokument?

2 PË. Po.

3 PY. A është zbatuar ky dokument nga njësitë tuaja?

4 PË. Mendoj që, po, është zbatuar edhe pse jo çdo herë kemi
5 pas mundësi dhe mekanizma tjerë për ta verifikuar ose
6 konfirmuar një gjë të tillë. Mirëpo mendoj që është zbatuar në
7 masë të madhe, nëse jo plotësisht.

8 PY. Faleminderit.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të kalojmë tek faqja
10 tjetër.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk e di a mund t'ju
12 ndërpres?

13 Dëshmitar, ju lutem, lexoni fjalinë e fundit të
14 dokumentit që keni përpara aty sipër datës 8 shkurt 1999? Ju
15 lutem, lexojeni pak. Lexojeni me zë.

16 DËSHMITARI: "Secila patrullë duhet të ketë të caktuar
17 udhëheqësin (duke ndërruar policët sipas radhës)" dhe vazhdon
18 mandej, "dhe në fund të çdo patrullimi udhëheqësi i patrullës
19 duhet të shkruajë raportin me shkrim."

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pastaj është një fjali
21 tjetër që përfundon me "01.03.1999". A mund ta lexoni dhe këtë
22 fjali ju lutem?

23 DËSHMITARI: "Vendimi hyn në fuqi më datën 1 mars 1999."

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Mendoj që kjo pjesa
25 mungon, fjalia e fundit mungon në versionin në anglisht.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

2 A mund të vazhdoj?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani do
5 tregoj disa faqe njëra pas tjetrës dhe sa i takon pranimit në
6 prova gjyqësore me këtë çështje do të merrem pak më vonë.

7 Do i kërkoja Sekretares që së pari të paraqesë në ekran
8 dokumentin me numër ERN 083045 në versionin në anglisht dhe në
9 shqip.

10 PY. Z. Krasniqi, a e keni parë më herët këtë dokument?

11 PË. Po, sigurisht.

12 PY. A ju kujtohet se pse e keni lëshuar këtë dokument?

13 PË. Po.

14 PY. A mund të na thoni shkurtimisht arsyet se pse e keni
15 nxjerrë këtë dokument?

16 PË. Para se të nxirrej ky dokument, unë dhe Bajram Gashi,
17 kemi kërkuar nga të dy skuadrat e policisë ushtarake që
18 vepronin në dy anët e bjeshkës ku operonte Brigada 121, kemi
19 kërkuar shënime për secilin polic apo pjesëtar të policisë
20 ushtarake, shënime të detajuara dhe kur na kanë arritur ato
21 shënime ka pasur disa mangësi, disa të dhëna të shënimeve për
22 disa nga policët e caktuar. Mandej kemi kërkuar shënime
23 plotësuese në mënyrë që t'i kompletojmë të dhënat për secilin
24 që ka qenë pjesë e togut të policisë ushtarake.

25 PY. Faleminderit.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për procesverbal dua të them që
2 dëshmitari besoj që tha "Bajram Gashi", ndërkohë që
3 procesverbali shkruan "Blerim".

4 PY. A është nënshkrimi juaj në këtë dokument, Dëshmitar, në
5 fund?

6 PË. Po.

7 PY. A është një dokument që është zbatuar në praktikë?

8 PË. Është zbatuar. Është zbatuar kjo.

9 PY. Faleminderit.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja tjetër
11 që ka numrin ERN 08046.

12 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

13 PË. Po, e kam parë.

14 PY. Kush e ka lëshuar këtë dokument?

15 PË. Ky dokument është lëshuar nga brigada dhe komandanti i
16 brigadës, mirëpo është nënshkruar nga përgjegjësi apo shefi i
17 personelit të brigadës.

18 PY. Çerkin Dukolli?

19 PË. Po, saktë.

20 PY. Ju përmendët që e keni parë atë. Po a e keni marrë këtë
21 dokument në atë kohë, Dëshmitar?

22 PË. Gjithsesi e kam marrë këtë dokument sepse këtu, siç
23 shihet në dokument, është një detyrë, një urdhëresë dedikuar
24 togut të policisë ushtarake të Brigadës 121 dhe është një
25 formë që kemi operuar përmes detyrave të tilla të cilat na u

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice (Vazhdon)

Faqe 22

1 janë dhënë.

2 PY. A e keni zbatuar atë?

3 PË. Çdo detyrë e dhënë gjithmonë është zbatuar deri në masën
4 që kanë lejuar rrethanat e luftës për t'u zbatuar.

5 PY. Faleminderit.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani le të kalojmë në faqen në
7 PDF 125, që ka numrin ERN 083050.

8 PY. A e keni parë më herë këtë dokument, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. A e dini se kush e ka nxjerrë këtë dokument?

11 PË. Po, komandanti i brigadës.

12 PY. I kujt është ky nënshkrimi në fund të dokumentit?

13 PË. Ky nënshkrimi duket i njëjtë me nënshkrimin në dokumenta
14 tjera, që duhet të jetë i z. Haxhi Shala.

15 PY. A e keni marrë ju vetë këtë dokument?

16 PË. Po, gjithsesi.

17 PY. A e keni zbatuar atë?

18 PË. Siç thashë e dhe më herë, çdo detyrë që na është dhënë e
19 kemi zbatuar për aq sa u kanë leju rrethanat e kohës, do të
20 thotë, çdo detyrë është marrë me seriozitet dhe jemi munduar
21 që t'i zbatojmë të gjitha detyrat.

22 PY. Faleminderit.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] tani le të kalojmë në faqen PDF
24 127, që është numri ERN 083052.

25 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice (Vazhdon)

Faqe 23

1 PË. Po.

2 PY. A e dini kush e ka nënshkruar atë?

3 PË. Po.

4 PY. Kush e ka nënshkruar?

5 PË. Komandanti i brigadës.

6 PY. A e keni marrë këtë dokument ju?

7 PË. Po, e kam marrë.

8 PY. A e keni zbatuar atë?

9 PË. Njëjtë, siç u përgjigja dhe më herët, do të thotë, çdo
10 detyrë, vendim, urdhër e kemi zbatuar për aq sa kemi pasur
11 mundësi në kontekst të rrethanave.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani të kalojmë në faqen në PDF
13 162, në anglisht dhe në shqip, me numër ERN083087.

14 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

15 PË. Po, e kam parë.

16 PY. Në deklaratën tuaj keni thënë që Shefqet Bylykbashi ka
17 qenë një prej oficerëve të policisë. A jua ka dërguar këtë
18 raport ky person, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. A ju kujtohet --

21 PË. Po, e ka dërguar.

22 PY. -- në qoftë se e keni marrë këtë dokument, domethënë,
23 fillimisht ka qenë oficer policie pastaj ka qenë një prej
24 administratorëve?

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që

1 këto faqe të pranohen në prova gjyqësore. Për procesverbal,
2 bëhet fjalë për faqet me ERN 030044, 083045, 083046, 083050,
3 083052 dhe 083087.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
5 kundërshtime?

6 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
8 083044, 083045, 083046, 083050, 083052 dhe 083078 pranohen në
9 prova gjyqësore.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do kërkoja në qoftë se është e
11 mundur që të bëhen pjesë e provave me numër P2010.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këtë do sugjeroja dhe
13 unë. Faqet të cilat u përmendën nga Gjykatësi do t'i shtohen
14 provës ekzistuese gjyqësore P02010. Dhe klasifikimi i këtyre
15 dokumenteve është aktualisht konfidencial.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

17 PË. Tani do t'ju tregoj dy fotografi, Dëshmitar.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për këtë do i kërkoj Sekretares
19 që të paraqesë në ekran dokumentin 094436 deri në 094435 dhe
20 të shfaqet fillimisht faqja me ERN 074402.

21 PY. A ju kujtohet ta keni parë këtë fotografi përpara një
22 jave, Dëshmitar?

23 PË. Po, e kam parë.

24 PY. A njihni ndokënd në këtë fotografi?

25 PË. Nga gjashtë personat që janë në fotografi, së paku për

1 katër jam i sigurtë.

2 PY. A mund të na thoni se kë njihni me siguri duke filluar
3 nga e majtë në të djathtë. Atëherë personi i parë në të majtë,
4 a e njihni këtë person?

5 PË. Po, e njoh.

6 PY. Kush është ky?

7 PË. Z. Shukri Buja.

8 PY. Ngjitur me këtë është një grua, a e njihni kush është
9 ajo?

10 PË. Për këtë nuk jam i sigurtë. Më ngjan me dikë, mirëpo nuk
11 jam i sigurtë.

12 PY. Në rregull. Më pas në të djathtë të kësaj gruas është një
13 burrë. A e njihni kush është ky personi?

14 PË. Po. Personi i tretë sipas radhës në foto është z. Fatmir
15 Limaj.

16 PY. Po në të djathtë të Fatmir Limajt kush është?

17 PY. Në të djathtë apo në të majtë?

18 PY. Në të djathtë? Domethënë, personi i katërt nga e majta.

19 PË. Është z. Naser Shala.

20 PY. Naser Shala a ka pasur ndonjë nofkë, Dëshmitar?

21 PË. Po, ka pas nofkën Fytyra.

22 PY. Faleminderit. Po personi që ka mjekër që është ngjitur me
23 Naser Shalën a njihni kush është ky person?

24 PË. Edhe për këtë nuk jam i sigurtë për shkak të pak a shumë
25 cilësisë jo të mirë të fotos. Më ngjan edhe ky në një person,

1 ndërsa personi tjetër i fundit është e sigurtë që është z.

2 Shpëtim Telaku.

3 PY. Në rregull. Faleminderit. Po ky personi që ju thatë që të
4 shëmbëllen me dikënd, a mund të na thoni emrin e personit që
5 mendoni ju që mund të jetë por që s'jeni i sigurtë 100 për
6 qind?

7 PË. Po më ngjan me personin e quajtur Fatmir Shurdhi.

8 PY. Faleminderit.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj që kjo fotografi të
10 pranohet si provë gjyqësore, në qoftë se është e mundur t'i
11 shtohet provës ekzistuese P1095.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Çfarë relevance ka ky dokument?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
14 relevant dhe dokumenti 073496 deri në 073 -- jo, e thashë
15 gabim. Ta them dhe një herë tjetër. Kjo fletë, pra, kjo
16 fotografi do të pranohet dhe do t'i shtohet provës ekzistuese.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, Kryegjykatës, a
18 mund të na thoni se çfarë relevance ka kjo fotografi? A mund
19 të na e shpjegojë dot kolegja, Prokurorja? Nuk e kuptoj arsyen
20 se pse duhet të pranohet.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Dëshmitari ka folur lidhur me
22 bashkëpunimin me këta persona në deklaratën e vet e kështu që
23 ne mendojmë që është një fotografi e cila është relevante dhe
24 mbështetëse për sa i takon dëshmisë së dëshmitarit.

25 PY. Përpara sesa ta heq nga ekrani këtë fotografi, dua t'ju

1 pyes për vendin, a e njihni vendin ku mund të jetë bërë kjo
2 fotografi, Dëshmitar?

3 PË. Vendi në fotografi ngjan me ambientin e selisë apo
4 komandës së Brigadës 121 apo që para ofensivës së parë 1998
5 është përdor nga pika Çeliku. Po duke mos e përjashtu
6 mundësinë që të jetë edhe në Fshatin e Ri, do të thotë, këto
7 dy pika janë ku mund të jetë shkrep kjo foto.

8 PY. Faleminderit.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
10 paraqesë në ekran tani dokumentin SPOE00204138.

11 PY. A ju kujtohet ta keni parë këtë fotografi javën e shkuar,
12 Dëshmitar?

13 PË. Përveç e kam parë javën e shkuar, kjo foto ka qenë
14 publike dhe ka qarkullu shumë herë nëpër media.

15 PY. A i njihni personat që janë në këtë fotografi?

16 PË. Po, të gjithë i njoh.

17 PY. A mund të na thoni se kush janë këta persona, duke
18 filluar nga personat që janë ulur rreth tavolinës nga e majta
19 në të djathtë?

20 PË. Personi i parë ulur është z. Fatmir Limaj. Personi i dytë
21 është z. Hashim Thaçi dhe personi i tretë ulur është z.
22 Sylejman Selimi.

23 PY. Po ky burri që është pas Fatmir Limajt, kush është?

24 PË. Personi ulur pas z. Limaj është z. Shpëtim Telaku.

25 PY. A e dini se çfarë roli ka pasur shpëtim Telaku?

1 PË. Për aq sa unë e di, Shpëtim Telaku vazhdimisht ka qenë
2 truprojë e Fatmir Limajt, z. Limaj.

3 PY. Faleminderit. Po ku burri që është pas Sylejman Selimit,
4 kush është?

5 PË. Ky është z. Naser Shala me pseudonimin Fytyra.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që
8 këtë dokument ta pranoni si provë gjyqësore.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
10 kundërshtime?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
13 SPOE00204138 pranohet në prova gjyqësore.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
15 provës P02017. Aktualisht dokumenti është i klasifikuar si
16 konfidencial.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund ta riklasifikoni si publik.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
19 riklasifikoheni si dokument publik.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, vërej kohën.
21 Nuk e di në qoftë se do bëjmë ndonjë pushim tani apo jo?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
23 pushim për dhjetë minuta tani, Dëshmitar. Mund të largoheni
24 nga salla e gjyqit nën shoqërinë e Sekretares.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
2 pushim për dhjetë minuta.

3 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

4 --- Seanca rifillon në orën 10.10

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
6 dëshmitarin.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ndërkohë që presim dëshmitarin
8 mund t'ju informoj se do të kemi shumë dokumente gjatë
9 pyetjeve tona. Kështu që mund të kem nevojë për më shumë se
10 tre orë për pyetjet e mia.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
12 [Përkthim] Kur thoni dhe pak, sa?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mbase dhe gjysmë ore, por do t'ju
14 saktësoj më vonë këtë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
17 Mirë, Dëshmitar. Do të vazhdojë Prokuroria me pyetjet e
18 veta. Vazhdoni.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

20 PY. Z. Krasniqi, tani do t'ju tregoj një tjetër dokument që
21 ka ERN 124959 deri në 124990 në faqen 29 të PDF-së që
22 përndryshe ka numrin 124987.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, edhe përkthimin
24 përkrah.

25 PY. A ju kujtohet që ia dhatë ju Prokurorisë këtë dokument

1 javën e kaluar?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Nga e keni gjetur; si e keni gjetur këtë dokument?

4 PË. Ky dokument më është dhënë gjatë luftës në kuadër të
5 emërimit tim në një detyrë, siç e cekët në dokument dhe kanë
6 kaluar shumë vite dhe në ndërkohë do të thotë e kam gjetur
7 edhe sikur dokumentet tjera me disa dokumente personale.

8 PY. Faleminderit. A e dini kur e keni marrë? Nëse, mund të na
9 thoni me saktësi pak a shumë.

10 PË. Me saktësi nuk mund të them, por bazuar në datën se kur
11 është nxjerrë ky dokument, atëherë unë këtë dokument duhet ta
12 kem marrë pas datës 1 mars 1999. Kur them pas datës "1 mars"
13 mund të jetë pas disa dite apo një javë apo dy javë, apo --
14 nuk mund të jem më i saktë.

15 PY. Kush e ka nënshkruar?

16 PË. Komandanti i brigadës, z. Haxhi Shala.

17 PY. A ju kujtohet si e keni marrë; në ç'formë?

18 PË. Nuk ka pas mundësi tjetër përveç se ta marr në mënyrë
19 fizike kur zakonisht një gjë e tillë ka mund të ndodhë kur
20 kemi mbajtur takimet e brigadës, në nivel të brigadës, dhe aty
21 duhet ta kem marrë. Nuk ka mundësi tjetër ose formë tjetër.

22 PY. Ju thatë që kjo është për emërimin tuaj, pra, është një
23 dokument ku emëroheni ju si shef i sektorit të "Shërbimit
24 Informativ", në Brigadën 121. Në deklaratën tuaj, keni thënë
25 që jeni emëruar pranë ZKZ-së. Për këtë emërim bëhet fjalë? Kjo

1 është shkresa që ju emëron ju shef të ZKZ-së?

2 PË. Po, saktë. Mendoj se -- ka mund të përdoret terminologji
3 e gabuar. Mirëpo, fjala ka qenë për sektorin e ZKZ-së.

4 PY. Faleminderit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do kërkoja që të pranohej ky
6 dokument si provë gjyqësore.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

8 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Të njëjtin kundërshtim si më
9 herët. Këto janë dokumente që kanë dalë shumë vonë. Njësoj si
10 dokumenti tjetër, kështu që sugjerojmë që t'i jepet numër
11 provizor.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti do
13 të pranohet. Pra, do të pranohet faqja 124987, dhe përkthimi
14 në gjuhën angleze.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Një sqarim. Është
16 pranuar një faqe e këtij dokumenti tani që ka numrin SPOE0215
17 [Sipas përkthimit]; a doni ta bashkëngjisim edhe këtë faqe në
18 dokumentin e mëparshëm?

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, faleminderit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
22 ekran dokumentin SPOE00226490, bashkë me anglishten.

23 PY. Këtë dokument jua tregova javën e kaluar unë, por ju vetë
24 e kishit parë ndonjëherë më përpara?

25 PË. Jo nuk e kam parë më parë këtë dokument.

1 PY. Kush është Petrit Ujmiri? E njihni?

2 PË. Për të qenë korrekt në periudhën që i referohet
3 dokumenti, nuk e kam ditur kush është Petrit Ujmiri. Mirëpo,
4 më vonë e kam mësuar, sepse ka qenë edhe publike pas luftës
5 një gjë e tillë. Dhe e di që është z. Sokol Dobruna.

6 PY. Thatë që nuk e kishit parë më përpara, por a e kishit
7 marrë ndonjëherë këtë gjatë luftës?

8 PË. Kur e thashë se nuk e kam parë më parë, nënkupton se aq
9 më pak mund ta kem marrë.

10 PY. Faleminderit. Në dokument përmendet edhe kodi penal i
11 UÇK-së. A keni marrë ju ndonjëherë ndonjë kod penal të UÇK-së?

12 PË. Udhëzimet nuk më kanë munguar nga z. Sokol Dobruna.
13 Mirëpo, nuk kam marrë kod penal ushtarak asnjëherë, të
14 shkruar.

15 PY. Faleminderit. Vazhdojmë dhe flasim për çështjen e Sahit
16 Muhaxhehirit - [Shënim i përkthyeses: Shqiptimi sipas
17 Prokurores] - të cilin e kemi diskutuar në deklaratën tuaj.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe kjo është pasqyruar në provën
19 P2007.1. Ju lutem Sekretarisë të nxjerrë në ekran ERN 082936
20 [Sipas përkthimit] deri në 083087 dhe shohim faqen 2 në PDF të
21 këtij materiali.

22 PY. Ky është një dokument që mban datën 10 qershor 1999. A
23 është një dokument ky që është përgatitur gjatë kohës që
24 kishte një rast kundër Safet Muhaxherit?

25 PË. Po, saktë.

1 PY. E njihni nënshkrimin në të djathtë?

2 PË. Po, sigurisht që e njoh.

3 PY. Në paragrafin e fundit, sipas këtij dokumenti, Muhaxheri
4 ka thënë që e ka ndaluar policia ushtarake edhe e kanë çuar në
5 Fshatin e Ri më 9 qershor. E gjetët këtë pjesë? Në Fshatin e
6 Ri. Thuhet:

7 "Dy oficerë -- dy policë ushtarakë kanë ardh për të më
8 marrë më 6 qershor."

9 PË. Po, e gjeta.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim faqen tjetër në të dyja
11 gjuhët.

12 PY. Ky është dokument tjetër --

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po do ta
14 merrni dhe emrin e personit që e ka nënshkruar dokumentin?

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

16 PY. Z. Dëshmitar, thatë që e njohët nënshkrimin në dokument.
17 I kujt është ky nënshkrim?

18 PË. Nënshkrimi është i z. Asman Hoxha.

19 PY. Faleminderit.

20 Ju lutem, shihni nënshkrimet në këtë faqe dhe nëse i
21 njihni na thoni të kujt janë, kujt i përkasin.

22 PY. Nënshkrimi i parë është ku ka nënshkruar personi i
23 dyshuar Safet Muhaxheri. Nënshkrimi i dytë apo në mes është i
24 z. Asman Hoxha. Dhe nënshkrimi djathtas në fund duhet të jetë
25 i z. Nexhmi Krasniqi.

1 PY. Tani të shohim përmbajtjen e dokumentit. Thuhet këtu që
2 është marrë në pyetje Muhaxheri disa herë. Një herë është
3 mbajtur në Malishevë, aty s'i kanë bërë pyetje, më pas i kanë
4 bërë pyetje në Bellanicë në shkurt të '99-s. A ju kujtohet
5 nëse ju kanë informuar ju personalisht për marrjen në pyetje
6 të këtij personi në Bellanicë në shkurt të 1999?

7 PË. Në Bellanicë ka vepruar skuadra e policisë ushtarake të
8 cilën e ka udhëhequr z. Ukë Gegaj. Administrator ka qenë z.
9 Asman Hoxha. Dhe për të gjitha punët e tyre përfshirë edhe
10 intervistimin e personit të dyshuar kanë raportuar gjithmonë.

11 PY. Ky ka qenë -- ky dokument ka qenë pjesë e dosjes që i
12 transferuat ju prokurorit ushtarak?

13 PË. Patjetër. Çdo lëndë që është proceduar te prokurori
14 ushtarak dhe gjykata ushtarake në atë kohë ka marrë edhe
15 nënshkrimin e z. Dobruna ose z. Kryeziu si dëshmi për
16 dorëzimin e lëndës.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do ta shohim raportin në fjalë.
18 Është faqja 1 e këtij grupi dokumentesh. Ka ERN 082926. Për
19 procesverbal ky dokument është pjesë e provave materiale
20 shoqëruese që ka numrin P2010.

21 PY. Presim që të dalë edhe anglishtja. A është ky raporti,
22 kallëzimi penal që keni përgatitur ju për këtë çështje?

23 PË. Unë jam në dijeni të këtij dokumenti. Mirëpo, dokumenti
24 është përgatitur dhe nënshkruar nga z. Asman Hoxha dhe mund të
25 konkludoj se nga nëntë kallëzime penale është i vetmi kallëzim

1 penal i nënshkruar nga z. Hoxha.

2 PY. A e njihni nënshkrimin në të majtë të dokumentit?

3 PË. Po. Është nënshkrimi i prokurorit ushtarak të atëhershëm
4 i cili është nënshkruar apo që e ka pranuar lëndën me 15
5 qershor të vitit '99.

6 PY. Pra, ky është në njëfarë mënyre një konfirmim marrjeje,
7 që është dorëzuar?

8 PË. Saktë. Konfirmim marrje ose dorëzimi. Pranim dorëzimi i
9 lëndës, i çështjes.

10 PY. Kemi parë në dokumente të mëparshme bashkë se personi në
11 fjalë është ndaluar më 9 qershor edhe raporti i policisë është
12 15 qershor. Si ka mundësi që u deshën më shumë se 72 orë që të
13 përfundohej kjo çështje?

14 PË. Mendoj se është rasti i vetëm i cili -- në të cilin nuk
15 ka pasur mundësi të respektohet afati kohor prej 72 orësh, siç
16 e kemi qenë të udhëzuar, sepse siç e kam cekuar edhe gjatë
17 seancave përgatitore, secili rast ka pasur specifikat e veta
18 dhe ka imponuar një procedurë ndoshta ndryshe. Kjo mund të
19 ketë për të vetmen arsye se nga data 10, 11 apo 12 qershor unë
20 nuk kam qenë aty; kam kaluar në Prizren. Dhe z. Hoxha që nuk
21 ka nënshkruar asnjëherë kallëzim penal deri në këtë rast duhet
22 të ketë pasur dilema se si të veprojë. Ne s'kemi pasur mundësi
23 komunikimi në ato rrethana dhe kur e pa se u tejkalu afati dhe
24 është bërë vonë për ta dorëzuar çështjen atëherë ka nënshkruar
25 vetë. Prandaj thashë ka nënshkruar për herë të parë dhe të

1 fundit një kallëzim penal siç është ky.

2 PY. Faleminderit. Për procesverbal a mund të na e thoni emrin
3 e prokurorit ushtarak që e ka nënshkruar këtë raport?

4 PË. Nga ajo që di dhe kam parë, i vetmi prokuror ushtarak ka
5 qenë z. Haki Kryeziu.

6 PY. Me sa keni ju dijeni, Safet Muhaxheri është mbajtur i
7 ndaluar në Kleçkë, dhe nëse po, për sa kohë?

8 PË. Bazuar në dokumentacionin apo shkresat e këtij rasti,
9 shihet se z. Safet Muhaxheri është ndalu. Mirëpo, për sa kohë
10 dhe kur është liru atë nuk mund ta di as për këtë rast dhe as
11 për raste të tjera, sepse nuk ka qenë më detyrë dhe punë e
12 policisë ushtarake -- Do të thotë, - nëse mund të shtoj - në
13 momentin që çështja iu është dorëzuar gjykatës ushtarake apo
14 prokurorit -- prokurorisë ushtarake, aty edhe kanë përfundu
15 detyrat dhe përgjegjësitë e togut të policisë ushtarake të
16 brigadës.

17 PY. Faleminderit.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nga tri
19 faqet që i tregova dëshmitarit, do kërkoja pranimin e faqes që
20 ka numrin 082927 e cila është e vetmja faqe në fakt që nuk
21 është pjesë e provës P02010.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
23 kundërshtime? Me sa shoh nuk ka kundërshtime. Në rregull
24 atëherë. Dokumenti 082927 pranohet.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo faqe do t'i shtohet

1 provës me numër P02010 dhe klasifikimi është konfidencial.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

3 PY. Tani dua të flasim për një çështje tjetër. Ju na thatë në
4 deklaratën tuaj se Sokol Dobruna ka urdhëruar arrestimin e
5 Sabit Shalës dhe kjo është në provën P2007.4, faqet 4 dhe 5.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të nxjerrë në
7 ekran provën që ka numrin D200020.

8 PY. E njihni nënshkrimin në këtë dokument?

9 PË. Po, e njoh.

10 PY. A mund të na thoni i kujt është ky nënshkrimi?

11 PË. Nënshkrimi që ka përgatitur dhe ka dorëzuar këtë kallëzim
12 penal është i imi, në anën e djathtë ku është emri, mbiemri
13 dhe nënshkrimi; dhe në anën e majtë është data dhe nënshkrimi
14 i personit i cili ka pranuar çështjen.

15 PY. I kujt është ky nënshkrim?

16 PË. I z. Sokol Dobruna. I z. Sokol Dobruna.

17 PY. Nëse ju kujtohet, pasi arrestuan Sabit Shalën, fillimisht
18 ku e çuan?

19 PË. Është i vetmi person që është ndalu me urdhër të Sokol
20 Dobrunës dhe është i vetmi person që është mbajtur në Tërpezë
21 në të njëjtin objekt dhe shtëpi ku kemi qëndruar unë, Bajram
22 Gashi dhe disa motra medicinale, ku njëra prej tyre ka qenë
23 edhe motra e Bajram Gashit. Dhe nga aty, derisa kemi
24 përgatitur dosjen, kemi përcjellur çështjen dhe personin të z.
25 Sokol Dobruna, përkatësisht në qendrën e mbajtjes.

1 PY. Në rregull.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë te faqja tjetër.

3 PY. Ju lutem, a mund ta përsërisni edhe një herë pjesën e
4 fundit të përgjigjes që po jepnit, sepse ju ndërpreva edhe
5 ndërpreva edhe përkthyesen? Pra, ju thatë që e transmetuat, ia
6 përcollët dosjen z. Sokol Dobruna. Po pastaj çfarë thatë, a
7 mund ta thoni, a thatë ndonjë gjë tjetër përveç kësaj? Se fola
8 përpara sesa të përfundonte përkthimi.

9 PË. Si në çdo rast edhe në këtë rast, do të thotë janë
10 dorëzuar edhe çështje, lënda edhe personi është dërguar në
11 mbajtje. Në qendrën e mbajtjes ose ndalimit, qendrën e
12 ndalimit -- në Kleçkë.

13 PY. Në rregull.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani kalojmë te faqja tjetër e
15 këtij dokumenti.

16 PY. Po dokumenti që keni përpara, a është procesverbal i
17 intervistës që keni pasur juve me Sabit Shalën?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. A keni qenë i pranishëm gjatë kësaj interviste?

20 PË. Po.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të kalojmë drejt fundit të
22 faqes.

23 PY. Sikurse mund ta shikoni, në fund të faqes ka një
24 nënshkrim në të djathtë. A e njihni kujt i përket ky
25 nënshkrim?

1 PË. Pavarësisht -- cilësisë së dobët, ky duhet të jetë
2 nënshkrimi im, mendoj. Nënshkrimi im është.

3 PY. A ju kujtohet në qoftë se ka ardhur ndokush për të
4 kërkuar Sabit Shalën?

5 PË. Po, më kujtohet.

6 PY. A mund të na thoni kush?

7 PË. Pas disa dite, aty në Terpezë ku qëndronim në shtëpinë
8 afër shkollës së fshatit me Bajram Gashin dhe persona të tjerë
9 që i ceka më herët, ka ardhur prindi, përkatësisht babai i z.
10 Sabit Shala për ta kërkuar djalin e tij. Ka qenë së bashku me
11 një shoqërues.

12 PY. Për çfarë ju pyeti ju ai? Çfarë pyetjesh ju bëri?

13 PË. Ai pyeti për djalin e tij se ku e ka djalin, të cilin e
14 informova se djali e ka në qendrën e ndalimit në Kleçkë.

15 PY. A mund të na thoni, çfarë ndodhi më pas? Na tregoni.

16 PË. Pastaj tha se kam ardhur që unë të rri në vend të djalit
17 dhe djali të lirohet. Atëherë unë i shpjegova se nuk është në
18 kompetencat e mia një gjë e tillë dhe pasi që pyeti, i tregova
19 se kjo është në kompetencën e gjykatës ushtarake dhe ai kërkoi
20 që të takohet me kryetarin e gjykatës ushtarake për ta
21 diskutuar të njëjtën kërkesë të tij.

22 Megenëse Bajram Gashi, administrator i togut të policisë
23 ushtarake e njihte paraprakisht Habibin, atëherë ne së bashku
24 vendosëm t'ia bëjmë një favor dhe të shkojmë së bashku deri në
25 Divjakë për ta takuar z. Sokol Dobruna. Aty për t'u futur te

1 Shtabi i Përgjithshëm, përkatësisht te z. Sokol Dobruna, ka
2 pas një roje, ka qenë një Laura e vendosur aty, diku në hyrje
3 pak më lart. Dhe aty të tre kanë mbetur te Laura dhe roja ku
4 ka qenë për të hyrë në Shtabin e Përgjithshëm, ndërsa unë kam
5 shkuar te z. Sokol Dobruna.

6 Ia kam shpjeguar Sokol Dobrunës tërë atë që e thashë më
7 lart se kush ka ardhur dhe qëllimin pse ka ardhur dhe se donte
8 që ta takonte z. Dobruna. I njëjti u deklaroi se "si ka mundësi
9 me ardh krimineli me nxjerrë kriminelin nga burgu; me ardh
10 krimineli me garantu për kriminelin". Jo që nuk ka pranuar që të
11 takohet dhe diskutojë me prindin e Sabitit, por ka urdhëruar
12 përgjegjës të sigurimit të njësisë së Shtabit të Përgjithshëm
13 që t'i dërgojë dy persona të asaj njësie për ta ndaluar z.
14 Habib Shala.

15 PY. Në rregull. Do ju ndaloj pak sepse po flisni pak si
16 shpejt. Megjithatë, dua që të më sqaroni disa pika.

17 Ju thoni që ai ju ka thënë që "Si është e mundur që të
18 ketë një këshill kriminal që dikush tjetër të lirohet".

19 Domethënë, si -- kush e ka thënë këtë? Të na e sqaroni
20 edhe një herë çfarë thatë, Dëshmitar.

21 PË. Z. Sokol Dobruna tha: "Krimineli ka ardhur të nxjerrë
22 kriminelin apo të garantojë për kriminelin".

23 PY. Këtu në procesverbal të paktën thuhet që ai nuk pranoi që
24 ta lironte babain e Habibit, por ai urdhëroi një njësi të
25 Shtabit të Përgjithshëm që të dërgonte dy individë në mënyrë

1 të tillë që ta ndalonte Habib Shalën.”

2 A keni dashur të thoni që ai nuk pranoi që ta lironte
3 babain e Sabitit, apo po thoni që nuk pranoi që të
4 zëvendësonte Sabitin me Habibin, -- Sabitin - më falni - me
5 Habibin. Na e sqaroni pak, ju lutem.

6 PË. Nga vetë ajo që ai tha, deklaroi dhe urdhëroi që ta
7 ndalojë Habibin, kjo kuptohet që nuk ka pranuar, jo ta lirojë,
8 ta ndërrojë me Habibin, por as të diskutojë dhe as të takohet
9 fare me të.

10 PY. Ju thatë që ai ka dërguar dy persona nga njësitë e
11 Shtabit të Përgjithshëm për të arrestuar Habib Shalën. Kë
12 dërgoi ai më konkretisht? Dhe kujt i përkisnin këta dy
13 persona, domethënë, nga cili njësi, nga cila njësi ishin këta
14 dy persona?

15 PË. Cilët kanë qenë ata dy persona nuk mund ta di, por e di
16 që këtë detyrë ia ka dhënë një përgjegjësi të tyre, mendoj që
17 ka qenë përgjegjës i asaj njësie z. Ramiz Sertolli. Dhe një
18 gjë të tillë ia ka kërkuar z. Ramiz Sertolli. Dhe mua pastaj
19 më kanë dalë aty për të trajtuar disa çështje të tjera. Dhe më
20 nuk kemi diskutuar për rastin në fjalë.

21 PY. A e dini se në çfarë njësie të Shtabit të Përgjithshëm
22 ishte z. Sertolli?

23 PË. Nuk mund të jem i sigurt; nuk mund të jem sigurt. Mund të
24 ketë qenë ndonjë polici ushtarake apo njësi tjetër. Mirëpo, ka
25 qenë njësi në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm.

- 1 PY. Në atë kohë dhe përpara sesa z. Dobruna lëshoi një
2 fletarresti për Habib Shalën, ju a kishit hetuar lidhur me të?
3 PË. Së bashku me urdhrin verbal të z. Dobruna për ta
4 arrestuar apo ndaluar z. Shala, Dobruna e kishte dhënë edhe
5 disa cilat janë dyshimet mbi bazën që ai don ta ndalojë. Do të
6 thotë, kishte dhënë disa elemente të dyshimit për bashkëpunim
7 të tina. Prandaj, meqë unë e kisha një bashkëpunëtor dhe i
8 vetmi që kam pasur gjatë luftës e kam -- ia kam dhënë si
9 detyrë që të mundohet t'i verifikojë ato dyshime që i kishte
10 ngritur z. Dobruna. Mirëpo, dua të sqaroj se pavarësisht
11 përgjigjeve apo informacioneve që do të sillte ky
12 bashkëpunëtor i imi -- nuk do e ndryshonte urdhëresën e dhënë.
13 PY. Për kë po flisni, për Sabit Shalën apo për Habib Shalën?
14 PË. Çdo herë po flas për Sabit Shalën, sepse ne nuk e kem
15 trajtuar çështjen e Habib Shalës. Ne nuk jemi marrë me
16 çështjen e Habib Shalës si polici ushtarake.
17 PY. Pra, ju nuk keni bërë hetime lidhur me Habib Shalën,
18 kështu?
19 PË. Absolutisht.
20 PY. A e dini se për çfarë akuzohej ai? Domethënë Habibi, për
21 çfarë akuzohej? E dini?
22 PË. Jo, nuk kam pas përveç asaj që djali i tij ka dhënë disa
23 gjëra në deklaratën e tij, unë nuk kam pasur asnjë dokument
24 dhe asgjë konkrete për Habibin.
25 PY. Faleminderit. A e dini në qoftë se Habibi dhe Sabiti kanë

1 qenë të ndaluar në Kleçkë?

2 PË. Po Sabiti po dihet tashmë që kanë qenë i ndaluar, sepse e
3 kemi dërguar sipas urdhrit të ndalimit dhe lëndës që vetëm e
4 kemi para vetes. Ndërsa Habibin është ndaluar në momentin që
5 kemi arritur para Shtabit të Përgjithshëm, siç e ceka më lart.

6 PY. Faleminderit. A e dini se për sa kohë kanë qenë të
7 ndaluar ata?

8 PË. Nuk e di sa kohë kanë qenë të ndaluar saktësisht as për
9 këta të dy dhe as për ndonjë tjetër, për vetëm siç e kam cekur
10 pas një periudhë kohore, nuk e di sa saktë. Bëhet fjalë gjatë
11 luftës. E kam takuar rastësisht në një grykë ku kanë qenë të
12 vendosur popullata e kanë qenë grykat si të themi e Shalës, e
13 Nekovcit, e Kishnarekës e kanë qenë gryka plot popullatë dhe
14 diku në një rën prej atyne grykave e kam takuar Habibin dhe në
15 atë moment e kuptova se qenka liru, por nuk më ka interesu të
16 merrem me tutje me të dhe me asnjë tjetër.

17 PY. Për ta sqaruar për procesverbal, me sa dini ju, në çfarë
18 vendi kanë qenë të ndaluar këta dy persona?

19 PË. Në qendrën e ndalimit në Kleçkë.

20 PY. Faleminderit. Tani do ju pyes lidhur me Mujë Telakun.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I kërkoj Sekretares që të
22 paraqesë përsëri në ekran dokumentin 08936 [Sipas përkthimit]
23 dhe të tregojë faqen në PDF 67 -- 64 - më falni - që ka numër
24 ERN-je 082989. Kjo faqe konkrete është pjesë e provës tani më
25 të pranuar P2010.

1 PY. A e keni parë më herët këtë raport? Një çast ju lutem. A
2 e keni parë më përpara këtë raport?

3 PË. Po, sigurisht që e kam parë.

4 PY. A e keni nënshkruar ju atë?

5 PË. Po, saktë.

6 PY. Në të majtë të dokumentit, a e njihni nënshkrimin? Kujt i
7 përket ky nënshkrim?

8 PË. Po, është data 20 mars '99 dhe është marrë në pranim nga
9 z. Sokol Dobruna.

10 PY. Faleminderit. Pretendimet lidhur me Telakun sikurse jepen
11 në këtë dokument është që ai ka arrestuar në mënyrë arbitrare
12 Sulejman Ramadanin, një person civil; a është e saktë kjo,
13 Dëshmitar?

14 PË. Ndonëse kualifikimet kanë mund të jenë të ashpra për
15 shkak se nuk kemi qenë profesional në kontekst të kohës, z.
16 Telaku ka ndaluar një person, por ne duke mos qenë njohës të
17 ligjit në atë periudhë e kemi quajtur arrestim arbitrar.

18 PY. Faleminderit. Në paragrafin e parafundit, thuhet që ju
19 keni bashkëlidhur deklaratën me shkrim në këtë kallëzim penal.
20 A ju kujtohet të ketë ngjarë, të ketë ndodhur kështu vërtet,
21 Dëshmitar?

22 PË. Çdo gjë që është e shkruar këtu patjetër që duhet të ketë
23 ngjarë, sepse në momentin e dorëzimit të çështjes të z.
24 Dobruna është dashur të jenë të gjitha dokumentet në të cilat
25 jemi mbështetur ose jemi thirrur ne si polici ushtarake.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 67 në
2 versionin PDF dhe në faqen 68. Numrat ERN për të dy faqe janë
3 082992 deri në 092993 [Sipas përkthimit].
4 PY. Në këtë rast, informacioni që jepet në këtë faqe, a është
5 marrë gjatë punës tuaj, Dëshmitar?
6 PË. Po. Përderisa i përket shkresave të rastit dhe është në
7 lëndën të cilës i referohemi, patjetër që është marrë në atë
8 periudhë.
9 PY. A ju kujtohet se kush e ka shtypur me makinë shkrimi ose
10 me kompjuter këtë?
11 PË. Mendoj se e njëjta është shtypur në Bellanicë në skuadrën
12 e policisë ushtarake të cilën e ka udhëhequr Ukë Gegaj nga
13 Asman Hoxha. Duhet të jetë shtypur nga z. Asman Hoxha.
14 PY. A e dini që çfarë pretendimi ose çfarë akuze është
15 ngritur kundër Ramadanit në momentin kur është ndaluar ai?
16 PË. Sipas asaj që më është thënë në atë periudhë dhe që
17 përmbajnë vetë dokumentet, ka qenë një dyshim për
18 kolaboracionist i pabazuar. Do të thotë nuk është sjellë asnjë
19 provë, asnjë dëshmi që të ketë bazë për ta proceduar tutje.
20 Dhe në konsultim me z. Dobruna, i njëjti është liruar në
21 mëngjes. Do të thotë ka qëndruar në mbajte gjatë natës me të
22 cilin ka qëndru për çështje sigurie z. Hoxha bashkë me të.
23 Dhe në mëngjes i njëjti -- përveçse është liruar edhe
24 është përcjellë deri në një vendbanim ku ai është ndi i sigurt
25 se mund të udhëtojë vetëm më tutje.

1 PY. Faleminderit. Në mënyrë që ta sqarojmë plotësisht. Kur ju
2 thoni që ka pasur dyshime që ai mund të ishte kolaboracionist,
3 për kë akuzohej ai se kishte bashkëpunuar; me kë kishte
4 bashkëpunuar ai kolaboracionist?

5 PË. Fjalë është kur i referohemi termin "kolaboracionist"
6 nënkuptohet bashkëpunimi me serbët. Mirëpo, që nuk ka pasur
7 ndonjë fakt për një dyshim të tillë.

8 PY. Në rregull. Dhe për këtë arsye ai është liruar, apo jo?

9 PË. Po, natyrisht është liruar.

10 PY. Në mes të këtij paragrafi thuhet që Ramadani ka thënë që
11 ka ndihmuar, e ka ndihmuar UÇK-në që të heqë trupa dhe se më
12 vonë ka mësuar se personi në fjalë ka qenë Muhamet Shapeta. A
13 e dini ju në qoftë se ky pretendim i ngritur nga z. Ramadani
14 është hetuar ndonjëherë nga ndokush?

15 PË. Ajo çfarë mund të them para Trupit Gjykues është se çdo
16 person i intervistuar dhe çfarëdo që ai ka thënë është e
17 regjistruar saktë në deklaratën e tij. Për informacionin në
18 fjalë ose për pretendimin e tij në fjalë as në atë periudhë
19 dhe as më vonë kurrë nuk e di se a ka qenë informacion i saktë
20 a jo.

21 Sa i përket pyetjes konkrete të Prokurores, unë nuk e di
22 a është hetuar, sepse edhe nëse nën supozim ka qenë rast i
23 vërtet atëherë nuk i ka takuar Brigadës 121. Dhe një detyrë e
24 tillë nuk ka mundur të kërkohet nga ne që ta hetojmë. Edhe
25 nëse është hetu, mund të jetë hetu nga njësi të tjera apo

1 brigada të tjera. Por sidoqoftë këto të dhëna të gjitha janë
2 dorëzuar së bashku me çështjen të z. Dobruna. Mendoj se ne nuk
3 kemi pasur kompetenca për t'u marrë më tutje me rastin

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më duhet
5 edhe pesë minuta të tjera për të përfunduar me këtë -- në këto
6 pyetje, me këtë pjesë pyetjesh. Kështu që do ju kërkoja në
7 qoftë se mund të vazhdoja sa të përfundoj pyetjet.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
9 nuk ju duhen më shumë pesë minuta, mund të vazhdoni.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares tani të
11 paraqesë në ekran një dokument në faqen PDF 65 që ka numrin
12 ERN-je 082990.

13 PY. A është ky një raport nga komandanti i togut, ku thuhet
14 që Telaku është -- Telaku ka ndaluar Ramadanin i cili është
15 mbajtur i ndaluar gjatë natës?

16 PË. Po, ky është një raport por jo nga komandanti i togut,
17 por nga komandanti i skuadrës së policisë ushtarake në
18 Bellanicë.

19 PY. Faleminderit.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani le të kalojmë në faqen PDF
21 66. Numri ERN është 082991.

22 PY. A e njihni i kujt është nënshkrimi i këtij raporti,
23 Dëshmitar?

24 PË. Po. Raporti është i nënshkruar nga komandanti i skuadrës
25 z. Ukë Gegaj, si dhe nga administratori i skuadrës z. Asman

1 Hoxha.

2 PY. Në raport thuhet që Ramadani është nxjerrë pas një urdhri
3 nga komandanti i zonës i ushtrisë -- i policisë ushtarake që
4 ka qenë Nexhmi Krasniqi. A është e vërtet kjo, Dëshmitar?

5 PË. Ajo, ajo çfarë mund të dëshmoj këtu është se urdhëresa
6 është lëshuar pas konsultimit që kam bërë me z. Dobruna. Tani
7 unë nuk e di a mund të ketë qenë në dijeni edhe z. Nexhmi
8 Krasniqi apo mund ta ketë përcjellë kalimthi të njëjtën gjë.
9 Mirëpo, një gjë e tillë është vendos pas konsultimin me z.
10 Dobruna, sepse nuk ka pas prova të bazuara për ta mbajtur më
11 tutje të ndaluarin.

12 PY. Faleminderit. Me aq sa keni dijeni ju, Telaku a është
13 arrestuar apo ndaluar si rezultat i kësaj çështjeje, kësaj
14 lënde?

15 PË. Me aq sa unë kam dijeni, z. Telaku, ndaj të cilit kemi
16 ushtruar kallëzim penal është intervistuar nga z. Dobruna.
17 Mirëpo, nuk është ndaluar.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
19 pranohen në prova gjyqësore faqet shtesë dhe këto faqe të
20 shtohen në provën ekzistues 02010, më konkretisht këto janë
21 faqet 082990 deri në 082993.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
23 kundërshtim lidhur me këtë? Ekipet nuk kanë kundërshtim.

24 Dokumenti 082992 deri në - ju kërkoj ndjesë, nuk më
25 kujtohet. Nuk e kam mbajtur shënim faqen tjetër. Mund t'i

1 përsërisni dhe një herë?

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, faqet që unë
3 kërkoj që të pranohen në prova gjyqësore janë 082990 deri në
4 993.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këto faqe do
6 pranohen në provën e referuar nga Prokurorja.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
8 nderuar Gjykatës, këto faqe do të shtohen në provën ekzistuese
9 P02010. Klasifikimi është konfidencial.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
11 tani do bëjmë pushimi gjysmë ore. Mund të dilni nga salla e
12 gjyqit. Do të kthehemi përsëri këtu në orën 11.30.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 --- Pauza e drekës fillon në orën 11.02

16 --- Seanca rifillon në orën 11.30

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
18 keni diçka.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Duam të bëjmë të qartë qëndrimin
20 tonë për procesverbal. Përpara pushimit Prokuroria i tregoi
21 një dëshmitar -- një dokument, më fal, dëshmitarit për një
22 dokument lidhur me një pretendim nga z. Ramadani që kishte të
23 bënte me ekzekutimin e pretenduar të një personi me emrin
24 Muhamet Shapeta, dhe hedhjen e trupit. Dhe më pas janë bërë
25 pyetje nëse është bërë ndonjë hetim lidhur, për këtë incident.

1 Pikësëpari në aktakuzë nuk përmendet asnjë person me
2 emrin Muhamet Shapeta, por jo vetëm kaq, por s'kemi asnjë
3 njoftim, asnjë dokument ku të përmendet ky person që të jetë
4 vrarë a të ketë ekzistuar fare. Kështu që ne e kundërshtojmë
5 këtë pistë pyetjesh nga ana e Prokurorisë. Nuk kemi asnjë
6 informacion lidhur me këto pretendime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
8 qëllim ta përdorni këtë informacion për ndonjë gjë të caktuar?

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë më shumë
10 e pyeta në një kontekst më të gjerë, për detyrat e tij dhe si
11 i ka trajtuar rastet.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por nuk doni
13 që të vërtetoni ndonjë pikë të caktuar?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sidoqoftë e
16 marrim parasysh kundërshtimin tuaj, z. Misetic.

17 Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,
20 Dëshmitar. Do të vazhdojmë me pyetjet nga ana e Prokurorisë.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. Z. Krasniqi, dua të flasim tani për rastin e Naser
23 Hasanit.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
25 ekran materialin 082926, 083087, dhe të shkojmë në faqen

1 082939, dhe në faqen 082940. Dhe për procesverbal më duhet të
2 them që të dyja faqet që do t'i tregojë dëshmitarit kanë marrë
3 numër prove dhe numri është P263.

4 PË. A është ky kallëzimi juaj penal drejtuar prokurorit
5 ushtarak për çështjen e Naser Hasanit?

6 PY. Po.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në faqen
8 tjetër.

9 PY. E shihni nënshkrimin tuaj në këtë dokument?

10 PË. Po.

11 PY. Po në të majtë, i kujt është nënshkrimi?

12 PË. Në të majtë është nënshkrimi i prokurorit Haki Kryeziu.

13 PY. Faleminderit. A ju kujtohet cilat kanë qenë akuzat kundër
14 Hasanit?

15 PË. Naser Hasani -- fillimisht, duhet të cekim se ka qenë
16 pjesëtar i UÇK-së. Mandej në, me uniformë të UÇK-së dhe në
17 emër të UÇK-së dhe Shtabit të Përgjithshëm ka kryer disa
18 plaçkitje në disa shtëpi në një fshat atje të Shtimes, dhe për
19 më tepër gjatë tërheqjes ka plagosur dy-tre civilë.

20 PY. Faleminderit.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim faqen 16 në PDF. Është
22 faqja me ERN 082941. Dhe t'i kalojmë faqet, domethënë shkojmë
23 tek faqja tjetër, dhe më pas tek faqja tjetër.

24 PY. Cilat janë nënshkrimet në fund të faqes?

25 PË. Siç mund të shihet edhe është dokumentin në fjalë,

1 nënshkrimi i parë është i personit të dyshuar, Naser Hasani.

2 Nënshkrimi në mes është procesmbajtësi, Asman Hoxha. Dhe

3 nënshkrimi i tretë është nënshkrimi im në cilësinë e

4 proceduesit.

5 PY. Ju kujtohet kush e ka marrë deklaratën?

6 PË. Pra, siç shihet në dokument, deklaratën e kam marrë unë

7 së bashku me Asman Hoxhën, apo me ndihmën e Asman Hoxhës.

8 PY. Ju kujtohet ku është marrë?

9 PË. Po. Deklarata është marrë në Kleçkë.

10 PY. Ku? Në ç'ambient, në ç'godinë, vend?

11 PË. Aty ku ka qenë qendra e ndalimit, sipër saj ka qenë një

12 kat i shtëpisë, përkatësisht një dhomë e cila ka shërbyer për

13 intervistimin e të ndaluarve nga z. Dobruna. Dhe për shkak të

14 mundësive të limituara të objekteve, e kemi përdor në disa

15 raste edhe ne me pëlqimin e z. Dobruna.

16 PY. A ju kujtohet nëse ka qenë i pranishëm vetë Dobruna kur

17 është marrë deklarata?

18 PË. Jo, gjatë marrjes së kësaj deklarate nuk ka qenë i

19 pranishëm Dobruna. Dobruna siç ma ka thënë edhe vetë, e ka

20 intervistuar pasi që ne ia kemi dorëzuar çështjen.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në faqen

22 tjetër, e cila mban ERN-në 082944.

23 PY. A është marrë edhe kjo gjatë kohës që po punonit me këtë

24 çështje, me këtë rast?

25 PË. Po. Sepse i dyshuari Naser Hasani ka pasur një sërë

1 shkeljesh, të cilat janë proceduar në një çështje të
2 përbashkët. Po mendoj në një kallëzim penal të përbashkët,
3 janë përfshirë shkeljet e dyshuara të z. Hasani.

4 PY. A i njihni nënshkrimet në këtë dokument?

5 PË. Njëjtë sikurse në dokumentin tjetër. Nënshkrimi i parë
6 është i të dyshuarit Naser Hasani, nënshkrimi i dytë është i
7 z. Asman Hoxha, dhe nënshkrimi i tretë është nënshkrimi im.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, faqja që
9 ka numrin 08294 -- [Mikrofoni çaktivizuar].

10 PY. Edhe ky dokument është përgatitur gjatë kësaj, gjatë
11 këtij rasti?

12 PË. Po. Është përgatitur gjatë këtij rasti, dhe i është
13 bashkëngjitur rastit të njëjtë, me personat si më parë,
14 nënshkruar nga i dyshuari, procesmbajtësi dhe proceduesi.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Atëherë, nga faqja 21, e këtij
16 dokumenti në PDF, që ka numrin 082946, të shkojmë tek PDF-ja
17 me faqen 40, që ka numrin 082965.

18 PY. Z. Krasniqi, do t'i kalojmë faqet një e nga një. Ju
19 lutem, hidhini një sy gjatë kohës që do t'i kalojë Sekretaria
20 dhe na thoni nëse janë përgatitur gjatë procesit, gjatë këtij
21 hetimi. Shkojmë në faqen tjetër, ju lutem?

22 PË. Po. Janë përgatitur gjatë rastit të njëjtë.

23 PY. Do t'ju bëj dhe një herë pyetjen në fund. Do t'i kalojmë,
24 do kalojmë faqet një nga një dhe në fund fare do t'jua bëj unë
25 pyetjen sërish. Vetëm shihini gjatë kësaj kohe, ju lutem.

1 PË. Mirë, mund ta kaloni. Mund ta kaloni. Mund ta kaloni.
2 Mund ta kaloni. Mund ta kaloni. Mund ta kaloni. Mund ta
3 kaloni. Mund ta kaloni. Mund ta kaloni. Kjo është vështirë e
4 lexueshme, është kopja tejet e dobët. Por megjithatë, e kam të
5 qartë pak a shumë natyrën e përmbajtjes.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për procesverbal, Dëshmitar, unë
7 -- për procesverbal, dëshmitari po i referohet faqes që
8 përfundon me numrin 082959.

9 DËSHMITARI: E qartë. Mund ta kaloni. Mund ta kaloni edhe
10 këtë. Mund ta kaloni. Gjithashtu edhe këtë.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

12 PY. Pra, të gjitha faqet që pamë, apo dokumentet që pamë a
13 ishin pjesë e dosjes së Naser Hasanit?

14 PË. Po, saktësisht. Të gjitha dokumentet që pamë, ishin pjesë
15 e dosjes apo e lëndës së Naser Hasanit.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër, ju
17 lutem, është faqja 41.

18 PY. Po këto shënime janë pjesë e dosjes së Naser Hasanit?

19 PË. Këto janë shënime nga një bashkëpunëtor i imi, që e ceka
20 më herët, dhe ndërlidhen direkt me rastin e Naser Hasanit.

21 PY. Mund të na thoni kush ka qenë bashkëpunëtor?

22 PË. Tash nëse s'ka pengesa ta them në seancë publike, mund ta
23 them.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 DËSHMITARI: Ka qenë -- z. Naim Baftiu.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

2 PY. Në deklaratë keni thënë se ju jepte informata gjatë kohës
3 që keni qenë pjesë e ZKZ-së. Kjo është thënë në provën
4 P2007.4, në faqen 3.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] -- në faqen tjetër.

6 Z. DIXON: [Përkthim] A do të bëhet ndonjë pyetje? S'po e
7 kuptoj pse e bën përmbledhjen Prokurorja dhe e la me kaq.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po s'e ka
9 lënë me kaq.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

11 PY. Çfarë është kjo?

12 PË. Këto nuk kanë kurrfarë relevance lidhur me rastin dhe
13 asnjë rast tjetër. Këto thjesht janë disa fatura në gjuhën
14 serbe, të cilat bashkëpunëtori im i ka përdorur për shënime në
15 anën tjetër.

16 PY. Kjo është -- pra, shënimet ishin marrë nga ana tjetër e
17 kësaj flete? Ishte thjesht si pjesë e një flete ku kishit
18 marrë shënime?

19 PË. Po, saktësisht. Saktë.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, të shohim faqen 51 në
21 PDF, e cila ka numër 082976.

22 PY. E njihni nënshkrimin në këtë faqe?

23 PË. Po, është nënshkrimi i z. Baftiu.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim në faqen 53 tani, që ka
25 numrin 082978. Dhe tani në faqen 58, që është me numër 082983.

1 PY. A janë edhe këto shënime të marra nga bashkëpunëtori apo
2 ndihmësi juaj lidhur me çështjen Hasani?

3 PË. Janë nga i njëjti bashkëpunëtor, mirëpo këtu mund të ketë
4 edhe ndonjë lloj informacioni të natyrës tjetër, siç shihet në
5 faqen e fundit.

6 PY. [Mikrofoni çaktivizuar] -- keni marrë kaq shumë deklarata
7 në këtë rast?

8 PË. Ky ka qenë një rast vërtet i komplikuar, ku janë
9 përfshirë edhe ushtarë të tjerë, që kanë dhënë ndihmë në një
10 formë apo në një formë tjetër. Dhe për këtë rast janë
11 intervistuar dhjetëra dëshmitarë që të kemi mundësi për ta
12 zbardhur rastin.

13 Mandej, është edhe arsyeja tjetër që në kontekst të
14 rrethanave të kohës, jo çdo herë e kemi pasur kohën e njëjtë
15 në dispozicion për të trajtuar rastin. Do të thotë, këtu i
16 është dhënë kohë më shumë, ka marrë më shumë, mendoj deri në
17 zbardhjen e këtij rasti. Prandaj e kam cekur dhe që secili
18 rast ka pasur specifikat e saj.

19 PY. A keni ndonjë dijeni, a është ndaluar Hasani si rezultat
20 i këtij procesi, pas këtij procesi?

21 PË. Po, gjithsesi është ndaluar.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja
23 pranimin e këtyre faqeve shtesë. Bëhet fjalë për faqet me
24 numër 082941, 082983. Dhe nëse pranohen, do kërkoja që t'i
25 shtoheshin provës P263, i cili është raporti origjinal.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
2 kundërshtime?

3 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim në vetvete, por
4 dua t'i kthehem parashtrimt që bëra pak më herët, por kur të
5 mos jetë dëshmitari, sepse u bë një përmbledhje e një prove,
6 dhe nuk mendoj që u bë një pyetje e mirëfilltë. Por do ta bëj
7 këtë në një moment kur dëshmitari nuk është i pranishëm, ose
8 në kundërpyetjet e mia.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndërsa ekipet
10 e tjera nuk kanë asgjë?

11 Në rregull, atëherë. Dokumenti 082941 deri në 082983, ky
12 është numri?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Pranohet dhe do t'i shtohet provës P263.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

17 Do lutesha tani që të vendosni në ekran materiali me
18 numër IT-03-66 P30, bashkë me përkthimin përkatës që ka numrin
19 IT-03-66 P30a.

20 PY. A ju kujtohet që jua tregova këtë dokument javën e
21 kaluar?

22 PË. Po.

23 PY. A e dalloni shkrimin e dorës, kaligrafinë, këtu?

24 PË. Mendoj se është shkrimi, mendoj se është i njëjti shkrim
25 i z. Baftiu.

1 PY. Faleminderit. Po të shohim shënimet, do shohim që ka
2 shënime për persona konkretë këtu. A është kjo natyra e
3 informatave që ju jepte Baftiu?

4 PË. Po pak a shumë, është natyrë e njëjtë.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, ju
6 lutem.

7 PY. A janë këto fatura të ngjashme me ato që janë përdorur
8 nga Baftiu në rastin e Naser Hasanit, këto fletë?

9 PË. Mendoj që po. Duhet të jenë fatura të njëjta, ose të
10 ngjashme.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim faqen 11 të PDF-së që me
12 numër U003-332 [Sipas përkthimit].

13 PY. E njihni këtë nënshkrim?

14 PË. Po.

15 PY. I kujt është?

16 PË. Është i, nënshkrimi i z. Baftiu.

17 PY. Faleminderit.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
19 pranimin e këtij dokumenti si provë gjyqësore.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
21 kundërshtime? Nuk ka.

22 Një faqe e vetme është?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, janë disa faqe.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cili numër
25 është?

- 1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është ai që fillon me IT.
- 2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
- 3 IT-03-66 P30 dhe përkthimi P30a, pranohet.
- 4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
- 5 dhe përkthimi në anglishte, do të marrë numër e provës P02018,
- 6 dhe klasifikimi është publik.
- 7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
- 8 ZNJ. IODICE: [Përkthim]
- 9 PY. Tani do t'ju pyes për rastin e Hysni Likës.
- 10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, vendosni dhe një herë
- 11 në ekran dokumentin që pamë më herët, do të shkojmë në faqen
- 12 84 të materialit në PDF, 083009.
- 13 PY. A ju kujtohet ky rast lidhur me një person që e kishte
- 14 emrin Hysni Likaj?
- 15 PË. Po, më kujtohet sepse e kemi kaluar edhe gjatë seancave
- 16 përgatitore.
- 17 PY. Në këtë dokument thuhet se është thirrur në
- 18 Shalë/Sedllarë, për një bisedë nga PU-ja, nga policia
- 19 ushtarake. A ju kujtohet dhe ju kështu?
- 20 PË. Po, më kujtohet që skuadra e policisë ushtarake në
- 21 Sedllarë na ka njoftuar lidhur me rastin dhe e kemi trajtuar
- 22 rastin.
- 23 PY. A ju kujtohen cilat kanë qenë akuzat kundër tij?
- 24 PË. Mendoj që ka pas indicie apo dyshime për
- 25 kolaboracionizëm.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja 85 në
2 versionin në PDF, që përndryshe ka numrin ERN 083010.
3 PY. Ky është një dokument që mban datën 2 janar. A është
4 pjesë e dokumentit, dokumentet që kanë të bëjnë me Hysni Likaj
5 kjo?

6 PË. Po është dokument që ka të bëjë me rastin e Hysni Likës,
7 në formë të deklaratës, e marrë nga komandanti i skuadrës në
8 Sedllarë.

9 PY. A e dini kush e ka nënshkruar këtë dokument?

10 PË. Pra, siç e thashë komandanti i skuadrës së policisë
11 ushtarake, në Sedllarë, i cili është quajtur Avni Shala.

12 PY. Këtu ai konfirmon se Lika është marrë për një intervistë
13 më datën 2 janar, dhe këtë datë në fakt dhe ky është një
14 proces i cili ishte shënuar gjithashtu edhe në dokumentin që
15 pamë pak më përpara. E konfirmoni këtë? A është e saktë kjo
16 dhe a ju kujtohet dhe ju që të ketë ndodhur kështu, Dëshmitar?

17 PË. Po, kështu duhet të ketë ndodhur.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 82 në
19 versionin në PDF, që përndryshe është dokumenti me numër ERN-
20 je 083007. Të shohim nënshkrimet në fund të faqes.

21 PY. A ka qenë dhe ky dokument si pjesë e dosjes?

22 PË. Unë mund të konstatoj se ky edhe ka qenë dokumenti
23 përfundimtar lidhur me rastin në fjalë.

24 PY. Të kujtve janë këto nënshkrime që shikojmë në fund të
25 faqes?

1 PË. Këto nënshkrime janë: nënshkrimi i parë është i personit
2 të dyshuar edhe pse këtu ka nënshkru si dëshmitari; nënshkrimi
3 në mes është i z. Shefqet Bylykbashi; dhe nënshkrimi djathtas
4 është i z. Sokol Dobruna.

5 PY. Kush e ka kryer intervistimin në këtë rast?

6 PË. Meqenëse ishim në fillim të marrjes së përgjegjësive në
7 policia ushtarake në kuadër të brigadës, dhe pasi që u
8 njoftuam nga skuadra e policia në Sedllarë lidhur me rastin,
9 duke mos pasur eksperiencë të mjaftueshme dhe njohuri ligjore
10 se si ta trajtojmë rastin, e kemi konsultu z. Dobruna i cili
11 ka shpreh gatishmërinë dhe ka ardhur së bashku me ne, i cili
12 edhe e ka intervistuar në këtë rast Hysni Likën.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë te faqja tjetër, që në
14 versionin në PDF është faqja 83, ndërkohë që numri ERN është
15 083008.

16 PY. Edhe ky dokument, a është pjesë e dosjes ligjore, apo jo,
17 Dëshmitar?

18 PË. Me aq sa mua më kujtohet, edhe ky dokument është pjesë e
19 rastit të njëjtë.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë drejt fundit të faqes
21 në versionin në shqip.

22 PY. A e dini kush e ka nënshkruar këtë?

23 PË. Këtu ku është, ku shkruan në të djathtën e dokumentit,
24 komandant i skuadrës, që realisht ka qenë z. Avni Shala. Nuk
25 është nënshkrimi i tij. Duket që shkruan PU Abeja. Do të

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Iodice (Vazhdon)

Faqe 62

1 thotë, në qoftë se po e deshifroj saktë, PU Abeja, atëherë
2 abeja e ka pasur nofkën njëri nga policët ushtarakë të kësaj
3 skuadre, me emrin Afrim Shamolli.

4 PY. Me sa keni dijeni ju, Dobruna a ka dhënë një vendim
5 lidhur me këtë rast?

6 PË. Siç e thashë edhe më herët, ky ka qenë ai dokumenti i
7 paraparak, ishte dokumenti përfundimtar lidhur me rastin, dhe
8 nuk e ka parë të nevojshme apo të bazuar apo të arsyeshme z.
9 Dobruna që të vazhdohet më tej me rastin. Dhe konsideroi se
10 rasti ka përfunduar aty.

11 PY. Faleminderit. A e dini në qoftë se Lika është ndaluar
12 ndonjëherë në Kleçkë?

13 PË. Nuk, për atë që mund ta them, mund ta them që ai edhe
14 mund të jetë ndaluar, por nuk është ndaluar nga policët
15 ushtarakë të Brigadës 121, edhe nëse është ndaluar.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj që këto faqe të pranohen
17 në prova gjyqësore, më konkretisht bëhet fjalë për faqet
18 083007 deri në 083010.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtime?

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
23 kundërshtim asnjë prej palëve.

24 Në këtë rast dokumenti 083007 deri në 083010, pranohen në
25 prova gjyqësore.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund t'i shtohen provës
2 ekzistuese P2010?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
4 nuk ka kundërshtim, këto fletë do të shtohen në provën
5 ekzistuese P2010.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Tani do kalojmë tek rasti që juve e keni quajtur si rasti
8 i Krojmirit. Ne -- ju e keni diskutuar këtë në deklaratën
9 tuaj, keni thënë që kanë qenë të përfshirë katër oficerë të
10 policisë ushtarake, një ushtar dhe Rexhep Selimi. Kjo jepet në
11 provën P2007.4, në faqet 10 deri 17.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Përpara se t'ju bëj pyetjet, do i
13 kërkoja Sekretares që të paraqesë në ekran faqen 130, në
14 versionin PDF, dhe më konkretisht numri ERN është 083055.

15 PY. Këtu shohim një deklaratë të Faik Shalës. A është ky
16 njëri prej viktimave në këtë rast, Dëshmitar?

17 PË. Po, saktë. Ky është njëri ndër viktimat e këtyre
18 personave që i përmendët ju, dhe është nga fshati Ngucat.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër.

20 PY. Këtu, në fund thuhet që është shtuar jetëshkrimi dhe një
21 raport mjekësor.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kështu që në qoftë se do të
23 kalojmë tek faqja tjetër.

24 PY. Jepet autobiografia. A është ky dokument njëri prej
25 dokumenteve që i është bashkëlidhur?

1 PË. Po, e saktë. Ky është një autobiografi e shkurtër e z.

2 Faik Shala dhe mendoj të jetë shkruar nga vetë ai.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për procesverbal ky është
4 dokumenti 083057. Të kalojmë tek faqja tjetër, që është
5 083058.

6 PY. Po kjo faqe, a është raporti mjekësor që keni
7 bashkëlidhur?

8 PË. Edhe ky raport është pjesë e shkresave të këtij rasti. Do
9 të thotë, është një raport mjekësor që pasqyron lëndimet që ka
10 pësuar z. Shala.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tani në faqen në PDF
12 138, që numri i ERN është 083063. Të kalojmë tek faqja tjetër
13 e këtij dokumenti.

14 PY. Kjo është një deklaratë e Elmi Ollurit. Edhe kjo
15 deklaratë ka qenë pjesë e dokumentacionit, apo jo, Dëshmitar?

16 PË. Po, ky është Dr. Elmi Olluri i cili ka paraqitur një
17 ankesë një shqetësim ndaj personave të dyshuar, dhe iu është
18 bashkangjitur lëndës.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqet e mëposhtme,
20 dhe të kalojmë ngadalë, nga faqja që është më poshtë, deri në
21 faqen 083066.

22 DËSHMITARI: Dokumentin që kam përpara është po ai
23 dokument që e pamë paraprakisht, i doktorit në fjalë. Mirëpo,
24 këtu është bërë me dorë të lirë të tij, dhe ne për ta lexuar
25 më lehtë e kemi nxjerrë në formë të transkriptit.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë te faqja tjetër, dhe
2 më pas tek faqja tjetër. Vazhdojmë më tej. Ju kërkoj ndjesë,
3 le të kalojmë një faqe më përpara.

4 PY. Ky është fundi i deklaratës që ka dhënë Olluri, apo jo,
5 Dëshmitar?

6 PË. Po, ky është fundi i deklaratës së Ollurit dhe siç shihet
7 aty në fund, shkruan:

8 "Ju përshëndes", më duket është, "Dr. Elmi Olluri".

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë tani tek faqja në
10 PDF 144, që ka numrin ERN 0830064 [Sipas përkthimit].

11 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

12 PË. Po, sigurisht që e kam parë.

13 PY. Çfarë është ky dokument?

14 PË. Kjo është, kjo është një deklaratë që i është marrë
15 personit të ndaluar, do të thotë njërin nga pesë personat e
16 ndaluar. Kanë qenë ky që është në këtë dokument.

17 PY. Kush e ka nënshkruar këtë dokument?

18 PË. Kjo deklaratë është marrë dhe është nënshkruar nga z.

19 Asman Hoxha.

20 PY. Në mënyrë të tillë që të jetë i qartë procesverbali, kur
21 thoni që ka qenë "individ i ndaluar", e keni fjalën për një të
22 dyshuar apo e keni fjalën për një person që është viktimë?

23 PË. Pikërisht ajo që u cek paraprakisht, do të thotë, që kanë
24 qenë katër policë ushtarakë të dyshuar, përfshirë edhe ky
25 ushtari, ky ka qenë ushtar i rregullt i UÇK-së.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë tani në dokumentin
2 në faqen 145 në PDF, me numër ERN-je 083070.

3 PY. Edhe ky dokument, a është pjesë e lëndës gjyqësore, apo
4 jo?

5 PË. Po, gjithsesi.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja tjetër.
7 Të kalojmë drejt fundit të faqes.

8 PY. A e njihni nënshkrimin, nënshkrimet që janë poshtë?

9 PË. Po, ky është personi i viktimës që u përmend më herët, z.
10 Faik Shala. Dhe personi tjetër që ia ka marrë këtë deklaratë
11 është Asman Hoxha.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë te faqja tjetër me
13 numër ERN-je 083072.

14 PY. Edhe ky dokument është pjesë e lëndës, apo jo?

15 PË. Po. Ky është dokument i një personi të intervistuar në
16 cilësinë e dëshmitarit të rastit, apo të rasteve, që kanë
17 ndodhur nga të dyshuarit.

18 PY. Faleminderit. Pra, të dyshuarit në rastin e Krojmirit,
19 apo jo?

20 PË. Po, pikërisht.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja tjetër.

22 PY. A i njihni nënshkrimet në këtë faqe, Dëshmitar?

23 PË. Po. Është nënshkrimi i dëshmitarit që i është marrë
24 deklarata, dhe është nënshkrimi i z. Asman Hoxha.

25 PY. Faleminderit.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër, me
2 numër ERN-je 083074.

3 PY. Edhe ky dokument është pjesë e rastit, lëndës, Dëshmitar?

4 PË. Po, edhe ky dokument është pjesë e rastit. Do të thotë,
5 është një dëshmitar tjetër, nëse s'gabo. Këtu ka nënshkruar,
6 mos janë dy dëshmitarë, ka mundësi të jenë dhe dy -- dy
7 nënshkrime këtu. Dhe procesmbajtësi dhe procedues dhe në këtë
8 rast është z. Asman Hoxha.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të vazhdojmë me faqen tjetër, me
10 numër ERN-je 083075.

11 PY. E njëjta pyetje dhe lidhur me këtë dokument. A është ky
12 një dokument që ka të bëjë me rastin e Krojmiri?

13 PË. Po, pikërisht ka të bëjë rastin e Krojmiri dhe
14 nënshkruar nga deklaruesi dhe procesmbajtësi, Asman Hoxha,
15 njëkohësisht ka nënshkruar edhe si procedues.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë në faqen në PDF
17 134, dhe numri i ERN-së për këtë faqe është 083059.

18 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

19 PË. Po, e kam parë.

20 PY. A është pjesë e rastit Krojmirë ky?

21 PË. Po.

22 PY. Kush e ka nënshkruar këtë dokument?

23 PË. Ky dokument është i nënshkruar nga komandanti i brigadës.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë në dokumentin në
25 PDF 137, që ka numrin ERN 083062. Data e këtij dokument është

1 30 prill.

2 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Kush e ka nënshkruar këtë dokument?

5 PË. Ky dokument është i nënshkruar nga z. Nexhmi Krasniqi.

6 PY. A ka qenë pjesë e rastit të Krojmirit ky dokument?

7 PË. Po, ka qenë. Po.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja 142 në
9 versionin në PDF, përndryshe dokumenti me numër ERN-je 083067.
10 Ky është një urdhër ose një urdhëresë që e ka datën 30 prill.

11 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

12 PË. Po, e kam parë.

13 PY. A është pjesë kjo e të njëjtit rast? A e keni hartuar
14 këtë urdhëresë si pjesë e punës që keni kryer për rastin e
15 Krojmirit?

16 PË. Ky në fakt është një ftesë ku dy policë ushtarakë iu
17 kërkohet që të paraqiten në komandën e policisë ushtarake në
18 Kleçkë.

19 PY. Këto janë dy të dyshuarit?

20 PË. Dy të dyshuarit. Dy nga pesë të dyshuarit.

21 PY. Kush e ka nënshkruar këtë dokument?

22 PË. E ka nënshkruar z. Nexhmi Krasniqi.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë në faqen 135, në
24 versionin PDF me numër ERN-je 083060.

25 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar? Është

1 dokument që mban datën 30 prill.

2 PË. Po, e kam parë.

3 PY. A ka qenë pjesë e rastit ky dokument?

4 PË. Po.

5 PY. A e dini kush e ka nënshkruar atë?

6 PË. Z. Nexhmi Krasniqi.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja tjetër.

8 PY. Kam të njëjtat pyetje dhe lidhur me këtë dokument. A ka
9 qenë pjesë e lëndës, e rastit në fjalë ky dokument?

10 PË. Po, ka qenë.

11 PY. Kush e ka nënshkruar këtë dokument?

12 PË. Po ashtu z. Nexhmi Krasniqi.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani le të kalojmë në faqen e

14 PDF-së 153 që ka numrin ERN 083068. Është një vendim që mban
15 datën 1 maj.

16 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

17 PË. Po e kam parë.

18 PY. Kush e ka nënshkruar atë?

19 PË. E ka nënshkruar z. Nexhmi Krasniqi.

20 PY. Në paragrafin e parë, thuhet se cilat janë pretendimet
21 kundër katër personave. Dhe më konkretisht thuhet që ata kanë
22 kryer shkelje të rënda të arrestimit arbitrar, keqtrajtme të
23 personave civilë, izolime, e kështu me radhë.

24 Me sa ju kujtohet ju, a kanë qenë këto akuzat e ngritura
25 ndaj personave të përfshirë në rastin e Krojmirit?

1 PË. Po, pikërisht ka pasur ndalime, termi më adekuat, ndalime
2 arbitrare, ka pasur edhe keqtrajttime të personave civilë, dhe
3 të gjitha këto bazohen në deklaratat dhe dëshmitë e vetë
4 personave civilë lidhur me rastin.

5 PY. Në fjalinë e dytë, në paragrafin e dytë, në fund fare,
6 përmendet, në zonën e Shalës. A mund të na sqaroni cili ka
7 qenë kuptimi, pse është përmendur kjo zona e Shalës këtu?

8 PË. Po, mundem. Këto i referohet jo zonës operative të
9 Shalës, por e ka fjalën për vendbanimin Shalë ose ndryshe qysh
10 është quajtur atëherë, Sedllarë. Do të thotë, e ka fjalën në
11 vendbanimin e Shalës. Apo rreth Shalës.

12 PY. Faleminderit. Ky është vendimi për të hequr statusin
13 ushtarak për këta ushtarë të policisë ushtarake. Me sa keni
14 njohuri ju, Dëshmitar, a ka ndodhur vërtet kështu, është
15 zbatuar përmbajtja e këtij vendimi?

16 PË. Po, është zbatuar. Vetëm se duhet të shtoj vendimi ka
17 qenë i komandantit të brigadës. Mirëpo, ne këtu e kemi një
18 vendim të nënshkruar nga dikush tjetër, por që bazohet në
19 vendimin e komandantit të brigadës i cili ka pasur kompetenca
20 për një vendim të tillë.

21 PY. Faleminderit.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të kalojmë në faqen 158 në
23 PDF, me numër ERN-je 083083. Është një njoftim zyrtar që mban
24 datën 15 maj.

25 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 PY. A lidhet me të njëjtin rast ky dokument, që njihet
3 ndryshe si rasti i Krojmirit?

4 PË. Po.

5 PY. Kush e ka nënshkruar këtë dokument?

6 PË. Z. Nexhmi Krasniqi.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë ose të shfaqet në
8 ekran dokumenti me ERN 124959 deri në 124990, nga ky dokument
9 të shfaqim faqen 30 në PDF që konkretisht mban numrin ERN
10 124988.

11 PY. A ju kujtohet t'ia keni dhënë këtë dokument ZPS-së
12 përpara një jave, Dëshmitar?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Si e keni marrë, nga e keni marrë këtë dokument?

15 PË. Ky dokument patjetër që është marrë në kohën kur janë
16 zhvilluar këto ngjarje, apo në kohën kur është marrë ky
17 vendim. Mirëpo, që unë e kam gjetur sikurse disa dokumente të
18 tjera më vonë, para disa kohe e kam gjetur me disa dokumente
19 personale.

20 PY. A e njihni nënshkrimin në këtë dokument?

21 PË. Po.

22 PY. I kujt është ky nënshkrim?

23 PË. Nënshkrimi në këtë dokument është i komandantit të
24 brigadës, z. Haxhi Shala.

25 PY. Po formati i këtij dokumenti a është në pajtim me

1 dokumentet e tjera të cilat i ka nxjerrë Haxhi Shala dhe
2 komandanti i brigadës, domethënë formati, është i njëjti me
3 dokumentet e tjera?

4 PË. Tash formati nuk është që ka pas ndonjë format standard
5 sepse disa dokumente janë shtyp me kompjuter, siç mund të
6 shihet, disa me makinë shkrimi, mirëpo mund të them se është
7 një prej formateve që kanë nxjerrë brigada dhe për më tepër
8 janë me dijeni të rastit dhe di që është nxjerrë nga brigada.

9 PY. A ka të bëjë kjo me rastin e Krojmirit?

10 PË. Gjithsesi ka të bëjë.

11 PY. A mund të na shpjegoni se çfarë do të thotë pika 1 që
12 lexon që ankesat e parashtruara të hidhen poshtë?

13 PË. Bazuar në një shkresë paraprake që pamë që ndaj të
14 njëjtëve është marrë, do të thotë, komandanti i brigadës ka
15 marrë një vendim që policëve ushtarakë t'u hiqet statusi i
16 policit ushtarak dhe të njëjtët të transferohen në njësi të
17 ndryshme si ushtarë të rregullt të UÇK-së. Ata e kanë ushtruar
18 të drejtën e ankesës në brigadë, apo tek komandanti i brigadës
19 dhe komandanti i brigadës pasi ka shqyrtuar ankesat e tyre,
20 përmes këtij vendimi i ka hedhur poshtë si të pabaza dhe
21 joreale ankesat kundër vendimit të nxjerrë më 1 maj 1999.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
23 pranimin e dokumenteve që përdora deri tani, të cilët kanë
24 numrin 083055 deri në 083075, 083083 dhe 124988.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtim?

1 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kundërshtojmë dokumentet në
2 tërësi, por kundërshtojmë të fundit se për këtë jemi njoftuar
3 shumë vonë. Këtë e thashë dhe më herët. Kundërshtimi ynë është
4 mbi këto baza. Do ju lutesha që Prokuroria njësoj si me
5 dëshmitarët e tjerë, të kërkojë pranimin në fund të provave të
6 veta.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
8 083055, 083075 -- 083085?

9 ZNJ. IODICE: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 83?

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Unë po kërkoj pranimin e
12 dokumenteve që mbajnë numrin e përgjithshëm 083055, 083075 dhe
13 083083.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Po i
15 them edhe një herë numrat. Dokumenti 083055, 083075 pranohet.
16 Edhe dokumenti 083083 -- 82 më falni, dhe 124988 pranohen.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe është dokumenti 083083.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 [Përkthim] Pra, dokumenti i fundit të cilin e konsideroi,
20 e kundërshton z. Dixon, do të pranohet, rrjedhimisht
21 kundërshtimi rrëzohet, bazuar në vendimin që kemi dhënë më
22 herët.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Më duhet t'i përsëris
24 edhe një herë numrat, që të jemi të sigurt. Dokumenti i parë
25 është 083055, 083075, është faqja me numër 083083, dhe do t'i

1 shtohen provës P02010?

2 ZNJ. IODICE: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqja e fundit është
4 pjesë e disa faqeve që tashmë janë të pranuar, dhe kanë
5 numrin P02015.

6 ZNJ. IODICE: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faqja 124959 -- më
8 falni, 124988 deri në 124988, do t'i shtohet provës P02015.
9 Faleminderit.

10 ZNJ. IODICE: [Mikrofoni çaktivizuar] [Përkthim]

11 PY. Tani do të flasim për dëshminë që keni dhënë për këtë
12 rast. Ju thatë që e thirrët të dyshuarin në zyrën tuaj, dhe e
13 vendosët në burg, i morët armët, më falni, dhe e çuat në burg
14 në Kleçkë. I referohem provës P2007.4, faqet 11, 13. Thatë që
15 Dobruna nuk ishte atje, edhe çështja mund të ndikonte në
16 opinionin publik dhe UÇK-në, dhe më pas erdhi Rexhep Selimi.
17 Kjo është pjesë e dokumentit.

18 Sa e rëndësishme, sa i rëndësishëm ishte ky rast, çfarë
19 rëndësie kishte ky rast?

20 PË. Paraprakisht një korigjim. Këta janë këtu në zyrën e
21 njëjtë ku, në zyrën ku z. Dobruna i ka intervistuar të
22 dyshuarit apo të ndaluarit, që faktikisht nuk ka qenë zyrë e
23 jona, por që kemi shfrytëzuar në disa raste, në mungesë të
24 kushteve në rrethana të kohës.

25 Ky rast për neve ishte i rëndësishëm sepse drejtpërdrejt

1 e dëmtonte reputacionin e UÇK-së tek popullata, dhe kjo ishte
2 patjetër, mendoj, e rëndësishme për ne dhe për të gjithë. Të
3 njëjtët, ndaj të njëjtëve kishte ankesa të shumta, jo vetëm
4 nga civilët por kemi pranuar edhe dëshmi nga ushtarët e
5 rregullt. Prandaj është, edhe rast voluminoz ka qenë nëse mund
6 ta quajmë.

7 PY. A ju kujtohet nëse është diskutuar kjo në nivele më të
8 larta?

9 PË. Po, pikërisht këtu më është dashur konsulta me z. Dobruna
10 dhe kam shkuar që ta konsultoj, mirëpo me aq sa di, ai nuk ka
11 qenë i pranishëm aty. Nuk e di se ku është ndodh edhe jam kthyer
12 mbrapa. Personi i cili më ka informuar që nuk ndodhet aty
13 Dobruna, tani mund të ketë qenë z. Kryeziu, ka gjasa të ketë
14 qenë ai, apo dikush tjetër, të cilin e kam njoftuar edhe me
15 arsyet pse e kërkoja z. Dobruna.

16 Mirëpo, ballafaqimi me të ndaluarit ka ndodh të nesërmen.

17 PY. Në deklaratën tuaj keni dhënë hollësi lidhur me këtë
18 incident, do t'ju bëj disa pyetje, sidoqoftë.

19 Ju vazhduat ta hetonit këtë rast edhe pasi Rexhep Selimi
20 e liroi të dyshuarin?

21 PË. Mendoj që duhet bërë një dallim apo sqarim. Deri në atë
22 moment ku ka ndodhur ballafaqimi me të ndaluarit në prezencë
23 apo me prezencën e z. Selimi, rasti ka qenë duke u kualifikuar
24 si dyshim për vepra penale. Pasi që në një formë rasti u mbyll
25 dhe ata u liruan, atëherë ne në kuadër të Brigadës 121 rastin

1 e kemi trajtuar në, si shkelje disiplinore bazuar në
2 kompetencat e komandantit të brigadës. Dhe ashtu ka ndodhur.
3 PY. Faleminderit. Nga këto që thoni ju, të paktën si e kuptoj
4 unë, vendimi për t'i shkarkuar këta persona nga roli që kishin
5 si oficerë të policisë ushtarake, ka ardhur pas takimit me
6 Selimin. A e kam kuptuar drejt?

7 PË. Po, saktë. Sepse një gjë e tillë ishte në kompetencat e
8 komandantit të brigadës.

9 PY. Faleminderit. Ju kujtohet nëse ka marrë shënime Rexhep
10 Selimi gjatë atij takimi?

11 PË. Tani është pas viteve që kanë kalu, është një detaj që
12 nuk mund të jem i sigurt dhe specifik. Por nuk mund të jem i
13 sigurt. Nuk mund të jem i sigurt se a ka marrë shënime. Ka
14 mundësi të ketë marrë, nuk jam i sigurt.

15 PY. Faleminderit.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
17 ekran materialin SPOE00226483, SPOE00226489. Ky është një
18 procesverbal me shkrim dore i datës 1 maj.

19 PY. A ju kujtohet që e patë këtë dokument javën e kaluar?

20 PË. Po, hera e parë që e kam parë këtë dokument është javën e
21 kaluar në seancën përgatitore, përndryshe ky dokument nuk ka
22 ekzistuar në shkresat e lëndës, të cilat i kemi përgatitur në
23 kuadër të brigadës.

24 PY. Faleminderit. Në krye thotë, 121 Bashkim Fino, nga
25 dëshmia që keni dhënë ju, ky ka qenë pseudonimi juaj, apo jo?

1 PË. Në Brigadën 121, Ismet Jashari, Kumanova, nuk ka pas
2 person tjetër me të njëjtin pseudonim.

3 PY. Veç jush? Përveç jush, edhe ky person ka pas të njëjtin
4 pseudonim?

5 PË. Nuk e di a kuptova drejt, ndoshta ishte keqkuptim. Nuk ka
6 pasur person tjetër me këtë pseudonim, që nënkupton se duhet
7 të bëhet fjalë për mua.

8 PY. Përveç detyrave që kishit në policinë ushtarake, këtu
9 thuhet, përmendet dhe "Shërbimi Informativ", edhe Shërbimi
10 Informativ ka qenë një nga detyrat tuaja në maj të 1999?

11 PË. Po tash detyrat kanë qenë ato që e sqaruar në fillim të
12 seancës, lidhur me aktin e emërimit.

13 PY. Faleminderit. Këtu shohim disa akuza përfshirë këtu
14 burgimin arbitrar, përdorimin e dhunës fizike, izolime të
15 paraportuara. Këto akuza, a përputhen me akuzat që ishin
16 ngritur për oficerët e policisë ushtarake dhe ushtarët në
17 rastin e Krojmirit?

18 PË. Unë nuk e di nga kush është bërë ky shkrim përveç asaj që
19 kemi biseduar edhe një herë rreth këtij shkrimit. Mirëpo mund
20 të them se ndërlidhet me rastin që e trajtuam deri tani, do të
21 thotë, rastin e Krojmirit.

22 PY. Faleminderit.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër. Këto
24 janë shënime për Haxhi Shalën.

25 PY. A ka qenë ai i përfshirë në rastin e Krojmirit?

1 PË. Po, patjetër që ka qenë i përfshimë, sepse ne pamë një
2 sërë dokumente që vërtetojnë që është përfshirë. Si rast
3 disiplinor është trajtuar nga z. Shala.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë dy faqe, ju lutem. Më
5 duket se faqja 5.

6 PY. Në krye përmendet Ajvaz Korpuzi. A ka qenë Ajvaz Korpuzi
7 një prej të dyshuarve?

8 PË. Po, një prej të dyshuarve dhe prej të ndaluarve.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër, ju
10 lutem.

11 PY. E njëjta pyetje. Sylë Qeriqi a ka qenë po ashtu një prej
12 të dyshuarve?

13 PË. Po, njëjtë.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, Të kalojmë në faqen
15 tjetër.

16 PY. Po Arsim Haziri, ka qenë një prej të dyshuarve?

17 PË. Po, gjithashtu.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
19 pranimin e këtij dokumenti.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë
21 grupin? Ka kundërshtime?

22 Z. DIXON: [Përkthim] Po, i njëjti kundërshtim. E gjithë
23 kjo dëshmi mund të ishte marrë pa ia treguar dokumentet
24 dëshmitarit. Dhe dëshmia e tij është përdorur si një formë që
25 të merren këto dokumente dhe të pranohen si pjesë e provave

1 gjyqësore. Por ai në thelb nuk ka dijeni për këto dokumente.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
3 kundërshtimi.

4 Dokumenti SPOE00226483, 00226489, pranohet pasi përmbush
5 standardin *prima facie* të rregullës 138.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kam një pyetje për
7 përkthimin. Kemi dy përkthime të anglishtes, anglishtja pra ka
8 dy versione. Kemi një që është 6489 dhe një 6490.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dokumenti që përfundon me 89
10 është dokumenti i saktë.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
12 numrin P02019 dhe klasifikimi do të jetë konfidencial.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
14 riklasifikojmë?

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, mund të riklasifikohet.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
17 Riklasifikojeni si dokument publik.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, në 1999 a e keni diskutuar me ndokënd rastin e
20 rastin e Krojmirit?

21 Z. DIXON: [Përkthim] E kundërshtoj këtë pistë pyetjesh.
22 Arsyen ju e dini, unë mund të jap parashtrime pa praninë e
23 dëshmitarit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
25 të duhet të dilni për pak minuta nga salla.

1 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
2 këshillohen]

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti i fundit mori
6 gabimisht numrin P02018. Duhet të kishte marrë numër P02019.
7 Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
9 z. Dixon.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit për mundësinë. Kjo
11 lidhet me kundërshtimin që ngrita edhe dje, për paragrafët 97,
12 98 të Shënimit Përgatitor 2, sepse aty kanë dalë akuza të reja
13 kundër klientit tim, pretendime të reja, më falni, kundër
14 klientit tim. Do ju lutesha, të nderuar Gjykatës, të lexoni
15 dosjen paraprake në paragrafin 145 ku janë përcaktuar dhe
16 pretendimet lidhur me këtë rast. Dhe në atë rast, në rast, në
17 dosje nuk përmendet fare klienti im. Është hera e parë që
18 dalin pretendime të tilla.

19 Ju dje morët vendim i nderuar Gjykatës, se nuk duhet
20 përjashtuar, sepse Prokuroria nuk do kërkonte që të pranohej
21 dokumenti. Por, sidoqoftë, Prokuroria i bëri dhe pyetjet, dhe
22 madje nxori dëshmi *live* nga dëshmitari dhe kërkon që të
23 pranohet dokumenti. Ne mendoj që Prokuroria duhet ta kishte
24 kërkuar pranimin në një formë tjetër mbase, kjo është një
25 praktikë krejt e re dhe nuk ishim njoftuar fare për këtë

1 dokument përpara. Dhe nuk u jepet dot zgjidhja duke na thënë
2 ju që të bëjmë ne më pas hetimet tona, sepse "dëmi" është
3 bërë, sepse dëshmitari e ka dhënë dëshminë. Dhe nuk jemi në
4 pozita ta kundërpyesim sepse e kemi marrë shumë vonë këtë
5 informacion.

6 Plus, Prokuroria duhet të ketë, duhet të merret një masë
7 kundër Prokurorisë për këto njoftimet në moment kaq të
8 vonshëm, sepse nuk mund ta bëjnë në momentin e fundit. Nuk
9 mund t'i nxjerrin këto dokumente në momentin e fundit. Kanë
10 pasur shumë vite në dispozicion që të na i tregonin këto
11 dokumente. Dhe ne mendojmë që dokumenti nuk duhet pranuar dhe
12 Prokuroria nuk duhet ta nxjerrë këtë dëshmi *live* nga
13 dëshmitari lidhur me këto aspekte.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

16 Vlen ende, zbatohet ende vendimi që kemi bërë ne. Edhe do
17 t'i lejojmë të bëhen pyetjet për këtë.

18 Sillni dëshmitarin në sallë.

19 Pra do të lejohen pyetjet, pasi kemi marrë një vendim
20 lidhur me këtë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,

23 Dëshmitar, do vazhdoj Prokuroria me pyetjet e veta.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

25 PY. Në 1999, pasi ndodhi ky incident, ju e diskutuat këtë me

1 ndonjë person tjetër?

2 PË. Do të thotë, ky rast është biseduar me brigadën, është
3 biseduar me dikë në Shtabin e Përgjithshëm, dhe po ashtu në
4 ndërkohë pas disa dite është diskutuar edhe me z. Kadri
5 Veseli.

6 PY. A mund të, mund të na tregoni për këtë diskutim me z.
7 Kadri Veseli, kur ka ndodhur?

8 PË. Po, siç e thashë kjo ka ndodhur pas disa dite. Nuk e di
9 saktësisht sa. Më ka kërkuar në objektin ku kemi qëndruar në
10 Fshatin e Ri. Nuk e di a më ka gjetur herën e dytë apo herën e
11 tretë, dhe jemi larguar nga objekti dhe më ka pyetur lidhur me
12 rastin se çka ka ndodhur në atë rast, apo çka po ndodh, çka ka
13 ndodh.

14 PY. Saktësisht, a ju kujtohet për çfarë ju ka pyetur?

15 PË. Po tash ka pyetur për përmbajtjen e rastit, çka bëhet
16 fjalë, sepse me gjasë kishte dëgjuar si rast.

17 PY. A ju kujtohet nëse ia dhatë hollësitë për këtë rast?

18 PË. Nuk mund të them në mënyrë të hollësishme, sepse ishte
19 një bisedë e shkurtër, mirëpo mund të them që e kam informuar
20 në mënyrë të përmbledhur ose të përgjithësuar.

21 PY. A ju kujtohet nëse i keni përmendur pretendimet kundër
22 këtij të dyshuari ose më saktë, cilat ishin këto pretendime?

23 PË. Tash ne nuk kemi mbajtur kurrfarë evidence aty, dhe
24 specifikisht nuk mund ta parafrazoj bisedën që kemi bërë. Por,
25 logjikisht do të duhej të përmendej, të përmendej arsyet bazë

1 që kanë çuar në ndalimin e personave në fjalë.

2 PY. A ju kujtohet se çfarë përgjigje ju ka dhënë z. Veseli?

3 PË. Lidhur me veprimet me ta nuk është se kam marrë ndonjë
4 përgjigje apo që ta kem pyetur diçka, por siç e kam thënë
5 dosja e lëndës kishte dokumente shumë më shumë sepse vërtet ka
6 pasur ankesa të shumta nga, si nga qytetarët ashtu dhe nga
7 ushtarët ndaj personave në fjalë. Mirëpo, ditën e ballafaqimit
8 atë dosje me kërkesën e z. Rexhep Selimi, e ka marrur me vete
9 në mënyrë që ta shfletojë dhe të ma kthejë pas një jave ditë,
10 përkatësisht pasi ta ketë lexuar. Dhe në këtë rast i thashë
11 edhe z. Veseli për çështjen e dosjes, dhe ai më tha se "Paske
12 gabuar, sepse nuk do t'ua kthej atë dosje më".

13 PY. Faleminderit. Në atë kohë, a e dinit ju se kush ishte
14 Kadri Veseli?

15 PË. Natyrisht që e dija, jo vetëm unë, por qysh e kam thënë,
16 kujtoj, edhe ditën e djeshme, në komandën e brigadës ne i
17 dinim pjesën dërrmuese të pozicioneve të anëtarëve të Shtabit
18 të Përgjithshëm, për shkak të afërsisë fizike që kishim me ta.

19 PY. Çfarë pozite, ose sipas jush, çfarë pozicioni kishte?

20 PË. Po gjatë luftës, në fillim është njoft si udhëheqësi apo
21 shefi i ZKZ-së. Ndërsa më vonë pas themelimit të SHIK-ut ka
22 udhëhequr SHIK-un.

23 PY. Faleminderit. Por përpara kësaj dite, kishit pasur ndonjë
24 takim tjetër me z. Veseli ju, si ky lloj takimi?

25 PË. Takim për të diskutuar një çështje të ngjashme, jo. Mund

1 ta kem parë, por asnjëherë nuk ka ndodh ta trajtojmë një
2 çështje konkrete.

3 PY. Pas këtij takimi, e keni takuar ndonjëherë tjetër z.
4 Veseli?

5 PË. Gjithashtu, mund ta kem parë, por për të qenë më specifik
6 pas luftës më ka bërë ofertë që të inkuadrohem në SHIK.

7 PY. U kyçët ju në SHIK më pas?

8 PË. Po, oferta ka ardhur kujtoj kah fundi i vitit 1999,
9 ndërsa përgjigjen apo vendimin për t'u inkuadruar ia kam
10 dhënë, mund të jetë në fillim të 1999 eventualisht në -- 2000,
11 më fal, eventualisht në pranverën e vitit 2000.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kam kaluar në fakt kohën që më
13 ishte caktuar, por do lutesha të më jepnit dhe pak kohë për të
14 bërë pyetjet. Kam dhe rreth katër faqe por dhe disa dokumente
15 të tjera që do të doja t'i shihja me dëshmitarin.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe sa
17 minuta?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe 45 minuta besoj -- më falni,
19 dhe rreth 45 minuta.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
21 [Përkthim] Mirë do bëjmë pushimin tani.

22 Dëshmitar, tani do bëjmë pushimin e drekës, do kthehemi
23 në 14.30. Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Iodice, përdorët një

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice (Vazhdon)

Faqe 85

1 dokument, por nuk kërkuat që të pranohet. Nuk e di në qoftë se
2 e bëtë këtë në mënyrë të paqëllimshme? Sidoqoftë, do të doja
3 që ta verifikojta me ju. Është dokumenti SPOE00226490, është ky
4 udhëzimi i Petrit Ujmirit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk doja që të pranohet ky
6 dokument si provë gjyqësore. Faleminderit.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
9 deri në orën 14.30.

10 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

11 --- Seanca fillon në orën 14.30

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

13 Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Dëshmitar, do vazhdojmë me pyetje tjera të Prokurorisë.

17 Znj. Prokurore, e keni fjalën ju.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

19 Gjykatës.

20 PY. Mirëdita, z. Krasniqi. Dua t'ju pyes që a ju kujtohet një
21 person me emrin Sami Duga?

22 PË. Personi Sami Duga më kujtohet sipërfaqësisht të jetë
23 intervistuar, nëse nuk gaboju, diku, po nuk e kam -- veç nëse
24 më ndihmon me provën e kam më të lehtë me e kujtu.

25 Do të thotë, Sami Duga, Sami Duga, kujtoj që është

1 ndaluar në mënyrë arbitrare nga personat e dyshuar, kjo kaq e
2 kujtoj, do të thotë, rastin e Sami Dugës.

3 PY. E keni fjalën për të dyshuarit në lëndën Krojmir?

4 PË. Pikërisht, po.

5 PY. A e dini ju në qoftë se ndonjëherë ky person ka qenë i
6 ndaluar në Kleçkë?

7 PË. E kam mësuar këtë fakt gjatë rastit Kleçka. Do të thotë,
8 në shkresat e lëndës të rastit Kleçka e kam mësuar që ka qenë
9 i ndaluar, bazuar në shkresat e lëndës. Por jo gjatë luftës.

10 PY. Faleminderit. Tani do të kalojmë tek rasti i Petrit
11 Hoxhajt.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë që për
13 këtë të paraqesë në ekran dokumentin 082936 deri në 082938.
14 Për procesverbal, dua të them që ky dokument është pranuar si
15 prova P164. Dhe më konkretisht dua të shfaqet në ekran
16 dokumenti faqja me numër ERN 082934.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të na
18 e thoni dhe një herë emrin e personit për të cilin do flisni
19 tani?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Petrit Hoxha.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

23 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

24 PË. Po, e kam parë.

25 PY. A është ky një prej rasteve me të cilat ju jeni marrë ose

1 e keni trajtuar?

2 PË. Po, e saktë.

3 PY. A i njihni nënshkrimet që janë në fund të faqes?

4 PË. Po, i njoh.

5 PY. Të kujt janë këto nënshkrime?

6 PË. Nënshkrimi si person i autorizuar që ka nënshkruar
7 kallëzimin penal jam unë. Ndërsa në anën tjetër, praktikisht
8 në anën e majtë të dokumentit, që mban datën 15 maj 1999,
9 është nënshkrimi i prokurorit ushtarak i cili ka pranuar
10 lëndën.

11 PY. Faleminderit.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani të kalojmë në faqen 10 të
13 PDF që në numër ERN është 082935.

14 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

15 PË. Po, natyrisht që e kam parë.

16 PY. A është dokumenti i të njëjtës lënde gjyqësore?

17 PË. Po, është deklarata që i është marrë personit të dyshuar.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja tjetër.
19 Kalojmë më tej tek faqja tjetër.

20 PY. A i njihni nënshkrimet në fund të faqes, Dëshmitar?

21 PË. Po, nënshkrimi në fund është në këtë rast i deklaruesit e
22 të dyshuarit Petrit Hoxha si dhe i proceduesit, në këtë rast,
23 Asman Hoxha.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër me
25 numër ERN 082938.

1 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

2 PË. Po, e kam parë në shkresat e këtij rasti dhe mendoj ky
3 është dokumenti i parë iniciues lidhur me këtë rast.

4 PY. Faleminderit. A ju kujtohet në qoftë se e keni marrë këtë
5 dokument?

6 PË. Po, përderisa është në -- ka qenë në shkresat e lëndës së
7 rastit, atëherë dhe më pastaj sigurisht që e kam marrë.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek faqja 123
9 në PDF me ERN 083048.

10 PY. A je në gjendje të thuash në qoftë se ky dokument ka qenë
11 pjesë e lëndës ose rastit të Petrit Hoxhës?

12 PË. Unë kam menduar që do të duhej të ishte me rastin e
13 lëndës Petrit Hoxha edhe pse në data nuk korrespondon si duket
14 me rastin, përndryshe mu nuk më ndërlidhet me rast tjetër.

15 PY. A e njihni nënshkrimin në këtë dokument?

16 PË. Po, është nënshkrimi i z. Nexhmi Krasniqi.

17 PY. A ju kujtohet në qoftë se Petrit Hoxha ka qenë i ndaluar
18 në burgun e Kleçkës?

19 PË. Unë personalisht nuk e kam procedu, nuk ia kam marrë
20 deklaratën personalisht dhe nuk e kam pa fizikisht Petrit
21 Hoxhën. Mirëpo, me aq sa di dhe bazu në shkresat e lëndës, i
22 njëjti duhet të ketë qenë i ndaluar. Por edhe nëse ka qenë i
23 ndaluar, nuk e di se kush mund ta ketë dërgu në qendër të
24 mbajtjes.

25 PY. Faleminderit.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të kërkoj
2 që këto fletë shtesë të cilat i diskutova me dëshmitarin të
3 pranohen në prova gjyqësore, më saktë këto janë dokumentet
4 082935 deri në 082938 dhe dokumenti me numër ERN 083048. Në
5 qoftë se pranohen në prova gjyqësore do kërkoja që t'i
6 shtoheshin provës ekzistuese P264.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
8 kundërshtime?

9 Dokumenti 082935 deri në 082938 -- ju kërkoj ndjesë, e
10 thashë gabim, ta fillojmë dhe një herë nga fillimi. Dokumenti
11 083035 deri në 083038 plus dokumentin 083048 pranohen në prova
12 gjyqësore.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund të
14 sqaroj dhe një herë numrat ERN? Unë kërkoja që të pranohet
15 dokumenti 082935 deri në 082938 dhe dokumenti 083048.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
17 Gabimi ishte i imi. Këto dokumente pranohen në prova
18 gjyqësore.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dua të bëj një sqarim.
20 Dje ne pranuan faqet nga 082934 deri në 082937 si prova
21 shoqëruese, të P02010.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Atëherë bëhet fjalë vetëm për
23 dokumentin 38 dhe 083048.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë duhet t'i
25 shtohet provës 2010?

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Faqet

4 083908 dhe 083048 do t'i shtohen provës ekzistuese P02010.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

6 Tani do të bisedojmë për rastin e Osman Korpuzit. Do i

7 kërkoja Sekretares që për këtë arsye të na japë faqen 77 të

8 këtij dokumenti, me numër ERN 083002.

9 PY. A ju kujtohet ky rast, Dëshmitar?

10 PË. Po. Ky faktikisht është kallëzimi numër 2 penal që është

11 ushtru në gjykatën ushtarake, mban siglën e prokurorit

12 ushtarak, mirëpo i është dorëzu z. Sokol Dobruna, kryetar i

13 gjykatës ushtarake më datën 1 shkurt 1999.

14 PY. A i njihni dorëshkrimet në fund të dokumentit?

15 PË. Po. Ky kallëzim penal është përgatitur nga unë, është

16 nënshkruar nga z. Nexhmi Krasniqi sepse ende ka qenë komandant

17 i togut të policisë ushtarake në Brigadën 121. Ndërsa në anën

18 tjetër në krahun e majtë është nënshkrimi i z. Sokol Dobruna,

19 prefshi edhe pranimin e armës në të cilën i dyshuari ka kryer

20 veprën.

21 PY. Faleminderit.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja tjetër,

23 kjo faqe është me numër ERN 083003.

24 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

25 PË. Po, natyrisht e kam parë sepse kjo deklaratë të dyshuarit

1 i është marrë pikërisht nga unë dhe mban firmën time.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

3 Vazhdojmë me një faqe më poshtë.

4 PY. Ky është fundi i deklaratës, nënshkrimi këtu në fund
5 është nënshkrimi juaj, Dëshmitar?

6 PË. Po. Në dy vendet, do të thotë, në mes edhe djathtas është
7 nënshkrimi im, ndërsa majtas është nënshkrimi i personit të
8 dyshuar.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 14124 në PDF
10 me numër ERN 083049.

11 PY. E keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

12 PË. Po, sigurisht.

13 PY. A është lëshuar ai si pjesë e lëndës?

14 PË. Po.

15 PY. Lëndës Korpuzi?

16 PË. Po. Ndërlidhet me lëndën Korpuzi, por jo me çështjen
17 penale që i është dorëzu z. Sokol Dobruna. Sepse ky dokument
18 ka të bëjë me disa veprime pasi që është dorëzu çështja.

19 PY. Kush e ka nënshkruar këtë dokument? Kush e ka lëshuar
20 këtë dokument?

21 PË. Dokumenti është lëshuar nga komandanti i Brigadës 121 dhe
22 i kërkohet togut të policisë ushtarake, ku në këtë periudhë
23 kam qenë duke e udhëhequr unë, i kërkohet që armët të cilat
24 janë gjetur të dyshuarit Osman Korpuzi që ai i ka marrë në
25 mënyrë të parregullt nëpër vende të caktuara është kërku që të

Dëshmitari: Naser Krasniqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Iodice (Vazhdon)

Faqe 92

1 dorëzohen në Kleçkë, praktikisht në komandën e Brigadës 121.

2 PY. A e keni zbatuar atë?

3 PË. Po.

4 PY. A jeni në dijeni në qoftë se është marrë një vendim për
5 këtë rast?

6 PË. Jo vetëm për këtë rast, mirëpo un nuk jam në njohuri për
7 asnjë rast të jetë marrë ndonjë vendim.

8 PY. A e dini në qoftë se Osman Korpuzi është ndaluar?

9 PË. Po, po, është ndaluar. Po, e saktë.

10 PY. Ku është ndaluar ai?

11 PË. Është ndaluar, mendoj, nga njësia në Sedllarë por nuk e
12 di nga kush është dërguar në Kleçkë, në vendqëndrimin në
13 Kleçkë.

14 PY. Faleminderit.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që ky
16 dokument të pranohet në prova gjyqësore. Bëhet fjalë për
17 dokumentin me ERN 083002 deri në 083006 dhe dokumenti tjetër
18 me ERN 083049.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
20 kundërshtim? Përderisa sa nuk ka kundërshtim, dokumenti 083002
21 deri në 083006 dhe dokumenti 083049, pranohen në prova
22 gjyqësore.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto faqe do të shtohen
24 tek prova ekzistuese P02010. Faleminderit.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani dua që të diskutojmë lidhur

1 me rastin e Islam Çadrakut. A ju kujtohet ky rast, Dëshmitar?

2 PË. Po, më kujtohet.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares që të
4 kalojmë në faqen 61 PDF që është me numër ERN 082986.

5 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

6 PË. Ky dokument ka qenë pjesë e rastit Çadraku edhe pse tani
7 për tani është vështirë i lexueshëm në gjuhën shqipe.

8 PY. A e dini kush e ka nënshkruar atë?

9 PË. Ky duhet të jetë nënshkrimi i z. Nexhmi Krasniqi.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja 59 e të
11 njëjtit dokument me numër ERN 082984 që është pranuar si provë
12 P260.

13 PY. A është ky kallëzimi penal që ka të bëjë me rastin e
14 Islam Çadrakut, Dëshmitar?

15 PË. Po, pikërisht ky është kallëzimi penal i cili duhet të
16 jetë përgatitur nga z. Asman Hoxha dhe është nënshkruar nga z.
17 Nexhmi Krasniqi. Po ashtu në anën e majtë është pranuar nga
18 prokurori ushtarak z. Haki Kryeziu.

19 PY. Faleminderit.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
21 pranohet në prova gjyqësore faqen 082986.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju kërkoja, znj.
23 Iodice, që të shkonit ndoshta përsëri në faqen 61 të versionit
24 në PDF me numër ERN është 082986.

25 Juve i kërkuat dëshmitarit të thoshte diçka lidhur me

1 nënshkrimin në të djathtë. A mund ta pyesni dëshmitarin lidhur
2 me nënshkrimin në të majtë, në qoftë se ai e di se kujt i
3 përket ky nënshkrim?

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull.

5 PY. Dëshmitar, a e njihni nënshkrimin në të majtë të këtij
6 dokumenti, e dini kujt i përket ky nënshkrim?

7 PË. Unë, po, e di këtë nënshkrim në bazë të asaj që po shënon
8 Ilir Dukolli, mirëpo saktësisht nuk muj me thënë se për cilin
9 Ilir bëhet fjalë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
12 kundërshtim për pranimin e dokumentit që kërkojë Prokurorja që
13 është 082986.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
15 dëshmitari tha që nuk e lexon dot dokumentin në shqip. Dhe po
16 ashtu vërejmë që nënshkrimi në këtë dokument edhe në
17 dokumentin e mëparshëm që u kërkua dëshmitarit që të
18 komentonte lidhur me to, këto nënshkrime ndryshojnë, janë të
19 ndryshme nga njëra-tjetra. Pra, në këtë fazë dëshmitari nuk
20 mund të identifikojë nënshkrimin dhe përderisa shikon
21 versionin në anglisht dhe është emri Nexhmedin Krasniqi,
22 dëshmitari thotë që duhet të jetë e Nexhmedin Krasniqit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurore,
24 juve çfarë keni për të thënë në përgjigje?

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dëshmitari

1 tha që nuk është shumë i lexueshëm si dokument por i përket
2 rastit të Islam Çadrakut. Ai e ka parë këtë dokument në
3 seancën përgatitore duke parë gjithashtu edhe përkthimin në
4 anglisht, ka parë gjithashtu edhe pikën e dytë të ngritur nga
5 Mbrojtja. Megjithatë, dëshmitari ka komentuar mjaftueshëm për
6 arsye të rregullës 138.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti do
8 të pranohet që është faqe 082986. Pasi përmbush kriteret *prima*
9 *facie* sipas rregullës 138. Ju lutem caktojini një numër.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqja 082986 do të
11 shtohet në provën P02010.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Tani do të kalojmë tek rasti i Bajram Krasniqit.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të
15 kalojmë në faqen 4 PDF numri ERN i kësaj faqeje është 082929.

16 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, Dëshmitar?

17 PË. Po, sigurisht.

18 PY. A i njihni nënshkrimet që ka ky dokument?

19 PË. Po, ky është kallëzim penal i ushtruar ndaj personit të
20 dyshuar. Është përgatitur apo duhet të jetë përgatitur nga z.

21 Asman Hoxha. Është i nënshkruar nga z. Nexhmi Krasniqi. Po
22 ashtu këtë dokument e ka pranuar z. Sokol Dobruna.

23 PY. A e njihni nënshkrimin që është poshtë emrit që është
24 shkruar me shkronja shtypi Nexhmi Krasniqi?

25 PË. Po. Është nënshkrimi i zakonshëm, mendoj, i tij,

1 pavarësisht që s'jam unë ndonjë ekspert i shkrimit, por
2 shkrimi i tij duhet të jetë.

3 PY. Në të majtë, ajo çfarë shikoni aty, nënshkrimi a i takon
4 Sokol Dobrunës?

5 PË. Po. Veç e thashë paraprakisht, do të thotë, ky nënshkrim
6 i marrur më datë 8 qershor 1999 është nënshkrimi i z. Sokol
7 Dobruna.

8 PY. Sa për ta sqaruar, ky është rasti kundër Bajram
9 Krasniqit, kështu, apo jo? Është Behran Krasniqi, jo Bajram,
10 sepse në procesverbal është Bajram. Është Behran Krasniqi.

11 PË. Po. Keni të drejtë. Behram Krasniqi. Keni të drejtë.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër të
13 këtij materiali me numër ERN 082930.

14 PY. A është ky dokument po ashtu pjesë e rastit Krasniqi?

15 PË. Po. Ky është pikërisht dokumenti apo deklaratë e
16 komandantit të togut përmes së cilës është iniciuar ky rast.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

18 PY. A është edhe ky dokument pjesë e lëndës?

19 PË. Ky dokument, i quajtur deklaratë, është pikërisht
20 intervistimi që i është bërë z. Behram Krasniqi nga Asman
21 Hoxha, ku është i nënshkruar nga të dyja palët.

22 PY. Faleminderit.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja tjetër.

24 Të kalojmë tek faqja tjetër dhe të shohim nënshkrimet në fund
25 të faqes.

1 PY. A është edhe kjo pjesë e rastit, e lëndës?

2 PË. Po. Tash nuk u përqendrova, po mund të jetë deklarata e
3 njëjtë ku fillimisht i është me dorë të lirë dhe më pastaj
4 mund të jetë shtypur me makinë shkrimi

5 PY. Faleminderit.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj që këto faqe të pranohen
7 në prova gjyqësore. Më konkretisht këto faqe ishin 082929 deri
8 në 082931.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni
10 kundërshtime?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim lidhur me
12 pranueshmërinë, megjithatë ka rezultuar se raste të tilla si,
13 për shembull, i Behram Krasniqit nuk janë njoftuar në dosjen
14 paragjyqësore ose nuk janë as pjesë e aktakuzës. Kështu që në
15 këtë kuptim, ne kundërshtojmë përdorimin e tyre me përjashtim
16 të rasteve që ato, siç është deklaruar më përpara, do të
17 eksplorojnë detyrat që ka pasur dëshmitari.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
19 përgjigje për të dhënë për këtë, Prokurore?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, qëllimi
21 kryesor i kërkimit të pranimit të këtyre dokumenteve është që
22 të vërtetohet ose të flitet për politikën, pra, çfarë politike
23 ka pasur njësia që është drejtuar prej tij.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, sa për
25 procesverbal, këtu thuhet se "qëllimi kryesor" dhe në qoftë se

1 do ta marrim fjalë për fjalë i takon që ka dhe një qëllim
2 tjetër dytësor dhe ne i kundërshtojmë qëllime të tjera për sa
3 i takon përdorimit të këtij dokumenti.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne nuk e dimë
5 në qoftë se ka ndonjë qëllim tjetër tani për momentin, kështu
6 që ne nuk do shprehemi lidhur me qëllimet e tjera se nuk e
7 dimë këtë gjë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokument
10 082829 deri në 082933 pranohen.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

12 PY. Tani, Dëshmitar, kam disa pyetje të tjera për ju.
13 Ndërkohë që keni intervistuar të dyshuarit, a ju kujtohet në
14 qoftë se ka qenë i pranishëm një avokat i tyre?

15 PË. Fillimisht, nëse duhet t'ju përgjigjem direkt, atëherë
16 mund të them se nuk ka pas avokat të pranishëm.

17 PY. Sokol Dobruna a ju ka treguar ndonjëherë se duhet të
18 ishte i pranishëm një avokat?

19 PË. Të gjitha udhëzimet që na i ka dhënë qysh në fillim të
20 muajit dhjetor z. Dobruna i kemi zbatuar në përpikëri. Një
21 udhëzim të tillë që duhet avokat të ketë prezent, nuk e kemi
22 pasur. Sigurisht, bazuar në faktin dhe realitetin e rrethanave
23 se edhe po ta kishte dhënë një udhëzim të tillë, nuk ka pasur
24 avokat që të angazhohet në ato rrethana.

25 Ndoshta bazu në këtë fakt, që kjo është supozuese, nuk e

1 ka dhënë një udhëzim të tillë. Do të thotë, konfirmoj që nuk
2 ka pas udhëzim të tillë dhe nuk kemi pasur kuadër për ta
3 caktuar dikë si avokat. Për më tepër edhe nuk e kam pas një
4 njohuri të tillë të procedurës sepse i kam zbatuar vetëm ato
5 për të cilat jam udhëzuar dhe ashtu siç jam udhëzuar.
6 PY. Faleminderit. Tani do t'ju pyes për burgun e Lladrovcit.
7 Në deklaratën tuaj - që është me numër P2007.3, faqet 21 dhe
8 22 - keni thënë se keni dëgjuar për ekzistencën e një burgu në
9 Lladrovc.

10 Ju keni shkuar ndonjëherë vetë në Lladrovc?

11 PË. Çështja Lladrovc mendoj se është përmendur për herë të
12 parë në rastin Kleçka. Mirëpo, mendoj që nuk është sqaruar dhe
13 nuk është elaboruar. Unë mund të them, për aq sa unë e di, që
14 në Lladrovc nuk ka pasur burg, nuk ka pasur burg. Aty është
15 trajtuar një rast jashtë Brigadës 121 të cilin e ka trajtuar
16 z. Sokol Dobruna. Dhe pse unë jam në dijeni të rastit? Sepse
17 në atë periudhë kam qenë në Tërpezë, afër Lladrovcit ose pak
18 më afër dhe Sokol Dobruna më ka marrur me vete në mënyrë që ta
19 shoh mënyrën e të intervistuarit, në mënyrë që të mësoj nga
20 ana e tij. Kaq mund të them për Lladrovcin.

21 PY. Ju kujtohet me përafërsi kur ka ndodhur, pra, kur keni
22 shkuar atje me Dobrunën?

23 PË. Nuk mund ta jap ndonjë periudhë për faktin që nuk kam
24 pasur asnjë shënim sepse nuk ka qenë rast as i imi dhe as i
25 Brigadës 121. Ka qenë një ushtar i ndaluar i një zonës tjetër

1 të cilin e kanë sjellë tek Sokol Dobruna dhe e ka trajtuar

2 Sokol Dobruna.

3 PY. Faleminderit. Ju kujtohet kush ka qenë i dyshuari?

4 PË. Po. I dyshuari ka qenë Hamdi Thaçi i njohur me nofkën

5 Rrushi.

6 PY. Për çfarë akuzohej?

7 PË. Akuzohej për një konflikt që kishte pasur me një epror në

8 Drenicë, përkatësisht i dyshuari kinse kishte tentuar që ta

9 përdorë armën kundër tij.

10 PY. Kundër cilit oficer është përpjekur ta përdorë armën,

11 kush ishte ky oficeri?

12 PË. Sipas asaj që mbaj mend, ishte z. Sahit Jashari.

13 PY. Dhe si rezultoi ky rast?

14 PË. Më konkretisht, herën e parë e mbaj mend ta ketë

15 intervistuar z. Dobruna. Nëse nuk gaboj, herën e dytë apo të

16 tretën, më shumë mendoj ka enë hera e dytë, kur ka shku me

17 intervistë përsëri, më ka marrë me vete mua, por nuk e kemi

18 gjet të ndaluarin aty ku ishte duke u mbajtur.

19 PY. Ku ishte i ndaluari? Si ka mundësi që nuk e keni gjetur

20 dot?

21 PË. Do të thotë, siç mund ta keni parasysh rolin tim, un

22 vetëm kam qenë vëzhgues i këtij rasti. Dhe asgjë më tepër. Por

23 ajo që mbaj mend, do të thotë, me dikënd që komunikoi z.

24 Dobruna i thanë që mbrëmë ka ardhur dikush dhe e ka liruar.

25 PY. Si reagoi Dobruna?

1 PË. Ne morëm rrugën për t'u kthyer. Dhe gjatë rrugë, do të
2 thotë, natyrisht, ishte pjesë e bisedës për rastin, i cili
3 ndër të tjera, mbaj mend të më ketë thënë se "Ky është një
4 shembull i keq. Sepse edhe unë nuk kam pasur për qëllim që ta
5 ekzekutoj. Edhe unë do ta kisha liruar, mirëpo do ta kisha
6 liruar përmes procedurave, disa procedurave të rregullta, duke
7 përcjellur një mesazh tek ushtarët në mënyrë që të forcohet
8 disiplina. Ndërsa rasti i lirimit të tij", tha , "se përçon
9 mesazh të kundërt ose ka kundërefekt".

10 PY. Faleminderit. Tani do t'ju bëj pyetje për një temë
11 tjetër. A ju kujtohet një anëtar i UÇK-së me ermin Sami
12 Vehapi?

13 PË. Po, më kujtohet.

14 PY. Çfarë roli ka pasur?

15 PË. Sami Vehapi fillimisht, sigurisht, u dashtë të jetë
16 ushtar i rregullt si shumë të tjerë ose pjesëtar i UÇK-së.
17 Ndërsa në ndërkohë duhet të ketë qenë polic ushtarak në nivel
18 zone ose në ndonjë nivel tjetër, por në kuadër të brigadës nuk
19 ka qenë asnjëherë.

20 PY. Kur thoni "duhet të ketë qenë", ju e keni ditur që ka
21 qenë oficer i policisë ushtarake - më fal - polic ushtarak në
22 nivel zone?

23 PË. Po tani jo të gjithçka mund të më kujtohet me saktësinë
24 më të madhe. Por mendoj që ka mundur të jetë. Ka mundur të
25 jetë. Por s'mund të them me saktësi 100 për qind, sikur qysh

1 mund të flas për ata që i kam taku Brigadës 121.

2 PY. Z. Krasniqi, kam dhe pak pyetje për ju edhe do t'ua bëj
3 pyetjet dhe pres përgjigjen tuaj. Ne e kemi të qartë që ju
4 jeni gjykuar në Kosovë për ngjarjet e Kleçkës.

5 Keni marrë pjesë ju ndonjëherë në keqtrajtimin e
6 personave që janë mbajtur të ndaluar në Kleçkë?

7 PË. Jo, asnjëherë. Mendoj se një gjë e tillë është konstatu
8 dhe me aktgjykim të formës së prerë në rastin Kleçka.

9 PY. Faleminderit. Atëherë unë po ju bëj këtë propozim, po ju
10 propozoj këtë, që ju keni parë dhe keni bërë më shumë nga ç'po
11 pranoni këtu dhe ju keni parë që të ndaluarit janë keqtrajtuar
12 në Kleçkë. Çfarë keni për të thënë për këtë?

13 PË. A mundni ta përsëritni edhe një herë pyetjen të lutem?

14 PË. Po. Atëherë qëndrimi im është ky, ju keni parë dhe keni
15 bërë më shumë nga ç'jeni i gatshëm të ndani me ne këtu dhe ju
16 e dini, e keni ditur që të ndaluarit po keqtrajtoheshin në
17 Kleçkë. Çfarë keni për të thënë lidhur me këtë?

18 PË. Jo, nuk ka qenë e vërtetë absolutisht sepse së pari nuk e
19 di që ka pas keqtrajtime dhe e dyta nuk ka qenë në domenin tim
20 që ta di. Do të thotë, për rrethanat që po flasim ka qenë e
21 pamundur që ta di, duke shtuar se unë fillimisht unë nuk e di
22 dhe që kanë ndodhë ato gjëra. Po nën supozim, nëse kanë
23 ndodhë, s'kam pasur sesi ta di unë, përderisa nuk i kam taku
24 stafit të qendrës së mbajtjes.

25 PY. Faleminderit.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Përpara se të mbyllë pyetjet
3 Prokuroria, kam një pyetje, ky është qëndrimi i Prokurorisë o
4 çfarë qëndrimi ishte ky? Sepse ky është një sulm i
5 drejtpërdrejtë që lidhet me besueshmërinë e dëshmitarit. Cili
6 është burimi i këtij qëndrimi?

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk e di në duhet të përgjigjem
8 në prani të dëshmitarit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigju.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kjo është e bazuar nga provat që kemi
11 në këto dokumentet tona gjyqësore për përfshirjen e
12 dëshmitarit në keqtrajttime.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë ky është qëndrimi i
14 Prokurorisë?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokati i z.
16 Selimi keni radhën për të bërë kundërpjetet.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] A ishte pyetje për mua kjo apo?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Se mbase nuk u sqarua atëherë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Më jepni pesë minuta ju lutem, sa
22 të organizoj dokumentet.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] dhe keni
24 parasysh që në orën 3.30 do bëjmë një pushim.

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

1 Z. ROBERTS: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita, z. Krasniqi. Unë quhem Geoffrey Roberts. Dhe
3 jam avokati i z. Selimi. Do t'ju bëj sot pasdite pyetje por
4 edhe nesër paradite ka të ngjarë. Ju lutem nëse ndonjë pyetje
5 nuk është e qartë, mos hezitoni, lirisht më thoni të përsërisë
6 pyetjet. Edhe ju lutem përgjigjet të qarta dhe të shkurtra siç
7 dhe keni bërë deri tani. Qartë?

8 PË. E qartë. Mirë.

9 PY. Do të doja të fillonim me momentin e mbërritjes suaj në
10 Kosovë në prill të 1998, për të cilën ke folur në intervistën
11 me ZPS-në dhe ke folur për përpjekjet e ndryshme për të hyrë
12 në Kosovë po që kanë qenë të pasuksesshme fillimisht. Të
13 kujtohet që e ke thënë këtë Prokurorisë?

14 PË. Po, e saktë.

15 PY. Përfundimisht ju ka çuar një imam në Likovc. Ju nuk e
16 njihnit këtë imamin, ai ishte nga Shqipëria, po ai vetë me
17 dëshirën e tij ju ndihmoi, kështu?

18 PË. Ai ishte nga komuna e Klinës dhe pat ardhur në atë kohë
19 në Shqipëri për të marrë armatim dhe për t'u futur në Kosovë.

20 PY. Domethënë, e dinte itinerarin, rrugën ai, shtigjet,
21 kështu?

22 PË. Po, patjetër sepse atë rrugë ai e kishte bërë edhe herë
23 tjera.

24 PY. Likoci ka qenë vendi i parë ku ke shkuar?

25 PË. Po ne kemi lëvizur nëpër territore vetëm duke udhëtuar

1 është fjala. Një ndalesë pak minutëshe e kemi pas në Drenoc të
2 Zatriqit dhe mandej nuk kemi pas ndalesë tjetër deri në Likoc.
3 PY. Likoci zakonisht ishte vendi ku shkonin kryesisht
4 personat që vinin nga Shqipëria drejt Kosovës, apo jo, aty
5 ndalonin kryesisht?

6 PË. Po, e saktë. Po e saktë.

7 PY. Kur arrite atje, i ke thënë ZPS-së, pasi pushove pak
8 shkove të takoje një person me emrin Agron, e përmende dhe sot
9 më duket në Gjykatë. Të kujtohet?

10 PË. Përgjegjësinë e grupit që kemi udhëtuar nga Shqipëria
11 deri në Likoc e ka pasur z. Ramiz Qeriqi, Luani. Dhe ne kemi
12 qenë së bashku me grupin. Do të thotë, unë nuk kam shkuar ta
13 takoj vetë, bile për të qenë më i saktë, këtë proces e ka
14 udhëhequr Luani, mirëpo kemi qenë së bashku.

15 PY. Në intervistën tuaj, që ka numrin P02006.1, ju keni thënë
16 se më vonë kemi mësuar se Agroni, në fakt, ishte Rexhep
17 Selimi. Kur ka ndodhur? Kur e keni mësuar ju këtë gjë?

18 PË. Mund ta kem mësuar pas disa jave ndoshta. Por me saktësi
19 tani nuk mund ta them. Por, gjithsesi, para ofensivës së vitit
20 1998.

21 PY. I keni thënë Prokurorisë se Agroni të ka thënë ty se
22 Fatmir Limaj, Haxhi Shala dhe Ismet Jashari ishin të gjithë në
23 Kleçkë dhe për këtë arsye kërkove dhe ti që të shkoje në
24 Kleçkë. Të kujtohet që ia ke thënë këtë Prokurorisë?

25 PË. Unë qysh kur jam nis nga Zvicra për në Kosovë

1 destinacioni im ka qenë për të shkuar aty ku ndodhet z. Limaj
2 dhe të tjerët që i përmendët ju. Mirëpo nuk e kam ditur
3 saktësisht se në cilën pikë ndodhet. Dhe këtë e mësova
4 pikërisht nga z. Selimi, që atëherë e njihja si Agroni.

5 PY. Mesa keni ju dijeni, këta tre persona kanë shkuar vetë
6 vullnetarisht në Kleçkë, përpara se të shkonit ju?

7 PË. Kur unë kam arrit ata kanë qenë në Kleçkë ose i kam gjet
8 në Kleçkë sepse ata janë futur në Kosovë disa javë më herët,
9 së paku dy, tre javë.

10 PY. Po mesa dini ju, ata kanë shkuar atje se ka qenë zgjedhja
11 e tyre, me vullnetin e tyre, apo jo?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtoj. Cila është baza e
13 kësaj?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

15 Vazhdoni. Mund t'i përgjigjeni, Dëshmitar.

16 DËSHMITARI: Unë mendoj se e kam të vështirë me dhënë
17 përgjigje të saktë se si kanë shkuar ata. Vetëm ata mund ta
18 japin një përgjigje të saktë. Krejt çfarë mund të them, ata i
19 gjeta në Kleçkë. Nuk përjashtohet mundësia të jetë ashtu.
20 Mirëpo e kam problem të përgjigjem me saktësi.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim]

22 PY. Mesa keni ju dijeni, a kishin lidhje farefisnore ata në
23 atë zonë, familjarë, të afërm?

24 PË. Z. Limaj, po, ka pasur.

25 PY. Dhe, në fakt, mesa keni ju dijeni, këtë bënin shumica e

1 vullnetarëve të UÇK-së, apo jo? Shkonin pikërisht në zonat ku
2 kishin familjarë, ku kishin shokë, apo jo?

3 PË. Nëse i referohemi periudhës së para ofensivës së parë
4 1998, kryesisht veprohej në këtë mënyrë.

5 PY. Po. Po flasim për periudhën e mbërritjes tuaj që është
6 prill, maj 1998?

7 PË. Pikërisht.

8 PY. Nuk ju nevojitej ndonjë leje që të shkonit në Kleçkë, apo
9 jo?

10 PË. Nuk di çfarë të them për këtë.

11 PY. Në kuptimin, për shembull -- do ta formuloj ndryshe. Kur
12 i keni thënë ju Prokurorisë që ju vetë keni kërkuar të shkonit
13 në Kleçkë a mos do të ishte më e saktë të thonim që, në fakt,
14 ju thjesht i keni informuar personat që do të shkonit në
15 Kleçkë që keni njoftuar se do të shkonit ku ishin z. Limaj, z.
16 Ismet Jashari, pra, thjesht i keni informuar, nuk keni kërkuar
17 autorizim për këtë?

18 PË. Pasi që mendoj z. Selimi e ka informuar z. Limaj se unë
19 gjendem në Likoc, tash pas pak dite, shumë shpejt, nuk ka qenë
20 periudhë e gjatë, z. Limaj ka ardhur dhe më ka marrë në Likoc.

21 PY. Dhe ishte vetë dëshira juaj të shkonit në Kleçkë, apo jo?

22 PË. Sigurisht që ishte dëshira ime, por edhe kur është nis
23 nga Zvicra z. Limaj për në Kosovë dhe unë kam mbetur që të
24 nisem pak më vonë, qëllimi ka qenë që përsëri të jemi bashkë
25 në Kosovë sepse bashkë thuajse ishim larguar nga Kosova.

1 PY. Dhe z. Selimi ose Agroni që thoni ju në atë kohë, nuk
2 ishte personi që ju drejtonte ju në atë njësit, apo jo, nuk ju
3 udhëzoi ai për të shkuar në këtë njësit, apo jo?

4 PË. Për të qenë korrekt, neve në Shqipëri, Daja na tha që "Të
5 drejtohi tek Agroni. Dhe Agroni do ju drejton, do ju
6 sistemmon". Mirëpo, kur unë e kam takuar së bashku me grupin,
7 në këtë rast edhe me Luanin, z. Selimi, unë e kam pyetur se
8 "Ku ndodhet z. Limaj"? Më ka tregu se ku ndodhet. E ka njoftu,
9 nuk di në çfarë forme e ka njoftu dhe ka ardhë më ka marrë. Do
10 të thotë, kjo është e tëra sa i përket. Mirëpo nuk do të thotë
11 që më ka pajisë me ndonjë leje të veçantë ose autorizimi ose
12 për të shkuar atje. Kjo ka qenë e tëra.

13 PY. Në fakt ishte z. Limaj ai dhe jo z. Selimi, pra, z. Limaj
14 ishte personi që ju ndihmoi në përfshirjen tuaj, apo jo, apo
15 në rolin tuaj?

16 PË. Në çfarë kuptimi, të lutem? S'e kam të qartë.

17 PY. Po, patjetër. Pra, z. Limaj është ai që erdhi dhe ju mori
18 ju, pra, z. Limaj ka qenë personi i përfshirë në udhëtimin
19 tuaj drejt Kleçkës, apo jo?

20 PË. Nga z. Selimi e mora vesh dhe e kuptova se z. Limaj
21 ndodhet në Kleçkë dhe ka qenë z. Limaj që ka ardhë pastaj dhe
22 më ka marrë dhe më ka dërguar në Kleçkë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Roberts, a mund ta
24 sqaroni me dëshmitarin për cilin Daja e ka fjalën kur e ka
25 takuar në Shqipëri. Se ka pas të paktën dy persona me këtë

1 nofkë?

2 Z. ROBERTS: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, e dëgjuat pyetjen e Gjykatësi Mettraux, pra,
4 cili ishte Daja që takuat ju në Shqipëri?

5 PË. Në atë periudhë, nuk e kam ditur emrin e vërtetë të
6 Dajës, mirëpo më vonë e kam mësuar që ka qenë Azem Sylja, z.
7 Azem Sylja.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Roberts.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim]

10 PY. Ju po ashtu i keni thënë Prokurorisë se Luani, Ramiz
11 Qeriqi, këtë e keni thënë në intervistën tuaj. Është prova
12 P2006.1, 082908-TR-ET Pjesa 1 *Revised* I Korrigjuar Përkthimi
13 me Gojë E Rishikuar, faqja 13. Ju kërkoj ndjesë, Dëshmitar,
14 kjo është thjesht referencë për procesverbal. Ju, pra, i keni
15 thënë ZPS-së që Ramiz Qeriqi ka marrë urdhër nga Likovci që të
16 krijonte një njësit në Caralevë në zonën e Krojmirit. A
17 kujtohet t'ia keni thënë këtë Prokurorisë?

18 PË. Tani kualifikimet e terminologjisë edhe mund të
19 diskutohen. Mirëpo, z. Selimi më kujtohet t'i ketë thënë Ramiz
20 Qeriqit e që ai më së miri do ta dëshmonte për vete, që të
21 krijonte një pikë ose ta shtrijë UÇK-në në atë territor, në
22 atë pjesë.

23 PY. Kur thoni "terminologjia është e diskutueshme", ju doni
24 të thoni që ka qenë kërkesë nga z. Selimi apo ndonjë formë
25 tjetër udhëzimi, në ndonjë trajtë a ndonjë formë tjetër, çfarë

1 ka qenë?

2 PË. Po prandaj e thashë që terminologjia është e
3 diskutueshme. Sepse kur i ka thënë ose i ka kërkuar që ta
4 formojë ndonjë pikë në atë territor nga i përkiste dhe vetë z.
5 Qeriqi, atëherë kjo mund të kualifikohet në mënyra të
6 ndryshme. Unë vetëm po e dëshmojë atë që e kam dëgjuar dhe e
7 kam parë. Por nuk mendoj që do të duhej që ta bëj kualifikimin
8 e terminologjisë unë.

9 PY. E kuptojmë. Prandaj duam ta sqarojmë bashkë se ju keni
10 përdorur fjalën "urdhëresë" me Prokurorinë dhe donim të dinim
11 çfarë dëshmie keni lidhur me këtë.

12 PË. Mendoj që kam thënë e ka kërkuar ose i ka dhënë detyrë,
13 po dhe kjo i ka dhënë detyrë edhe kjo -- sepse dhe çështja e
14 detyrave është e interpretueshme. Do të thotë, në fund të
15 fundit, ne kishim shku në Kosovë për të luftuar. Dhe çdo
16 person nga jashtë kur shkonte në Kosovë nuk kishte informata
17 se ku do të ishte më mirë të vendosej dhe ka qenë tërësisht e
18 natyrshme që ato informata të merren nga personat që janë më
19 herët brenda apo që kanë qenë në vazhdimësi brenda vendit.
20 Mandej karakterin se a do duhej të quhej urdhëresë, a do duhej
21 të quhej vendim, a do duhej të quhej udhëzim, është çështje
22 tjetër.

23 PY. Të jemi të qartë, z. Qeriqi nëse dëshironte mund ta
24 kishte refuzuar dhe të shkonte diku tjetër, apo jo?

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtoj.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
2 kundërshtimi i Prokurorisë.

3 Ju lutem, Dëshmitar, përgjigjuni në qoftë se e dini.

4 DËSHMITARI: Tani mendoj që kjo është supozuese. Unë nuk e
5 di sesi do të veprohej në rastin konkret. Nuk mund ta di. Edhe
6 pse z. Qeriqi dhe ne të gjithë që kishim shku në atë periudhë
7 kemi shku për me ju bashkëngjitë UÇK-së dhe nuk e di që kemi
8 pas arsye ndoshta të refuzojmë. Po nëse do të kishim refuzu,
9 unë nuk e di si do të zhvillohej më tutje ngjarja, sepse kanë
10 qenë fillimet e krijimit të UÇK-së.

11 PY. Përpara se të bëjmë pushimin e parë, kam dhe një diçka
12 tjetër. Z. Qeriqi kishte lidhje familjare në zonën e
13 Krojmirit, apo jo, në zonën ku dhe shkoj?

14 PË. Jo lidhje familjare, por z. Qeriqi ishte nga ai
15 vendbanim. Domethënë, ishte i fshatit Krojmir.

16 PY. Po, ju kërkoj ndjesë. Pra, ishte fshati i tij.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. Mbase ky është
18 momenti i përshtatshëm për pushimin.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
20 dhjetë minuta pushim do të bëjmë tani.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të bëjmë
23 dhjetë minuta pushim.

24 --- Seanca ndërpritet në orën 15.30

25 --- Seanca rifillon në orën 15.41

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, z.
2 Sekretare, silleni dëshmitarin në sallë.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 Në rregull, mund të vazhdoni, z. Roberts.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

6 PY. Kam dy pyetje plotësuese lidhur me temën që po diskutonim
7 pak më herët, Dëshmitar, që ka të bëjë me hyrjen tuaj në
8 Kosovë, z. Krasniqi. A është e drejtë të thuhet ose të arrihet
9 në -- të thuhet në përmbledhje që vendimi për ju që të shkonit
10 në Kosovë është marrë së bashku prej jush dhe z. Limaj në
11 Zvicër përpara sesa juve të shkonit?

12 PË. A ka mundësi ta përsërisni pyetjen, ju lutem?

13 PY. Patjetër. Pyetja ishte kjo: Vendimi për të shkuar në
14 Kleçkë dhe për të përfunduar në Kleçkë, a është marrë prej
15 jush dhe z. Limaj përpara sesa ju të shkonit në Kosovë? A ka
16 qenë ky synimi, domethënë, vendimi për të shkuar në Kleçkë
17 është marrë përpara se të hynit në Kosovë? A ka qenë kështu,
18 apo jo?

19 PË. Unë nuk e kam dit ku ndodhet z. Limaj. Këtë e kam marrë
20 vesh pasi që kam arrit në Likovc. Sigurisht ndoshta për
21 çështje sigurie z. Limaj nuk ka dashur të ma japë vendndodhjen
22 përmes telefonit. Mirëpo, cili ka qenë qëllimi? Qëllimi ka
23 qenë që unë të shkoj te z. Limaj kudo që ai ndodhet, mirëpo
24 nuk e kam ditur se ku ndodhet ai derisa kam arritur në Kosovë.

25 PY. Megjithatë, synimi ose qëllimi ishte që të shkonit dhe të

1 takonit dhe të ishit me z. Limaj, pavarësisht se ku ishte z.

2 Limaj. A është kështu?

3 PË. E saktë.

4 PY. Sa i takon Likocit dhe Prekazit, a është e drejtë të

5 thuhet që Likoci është qyteza më e afërt me Prekazin ose

6 qyteza e vogël dhe me madhësi të arsyeshme që është afër

7 Prekazit? A mund të thuhet kështu?

8 PË. Nuk e di saktësisht sa afër është, e di që kur kemi qenë

9 ne në Likoc ka qenë afër me fshatin Plluzhinë. Mendoj se gjatë

10 atyre ditëve kemi frekuentu këto dy lokacione, Likoc dhe

11 Plluzhinë. Ama bëhet fjalë për pak ditë, jo shumë.

12 PY. Ju lutem, a e përsërisni dhe një herë atë çfarë thatë

13 sepse përkthyesi nuk e kapi fshatin që përmendët në përgjigje.

14 Pra, filluat duke thënë që:

15 "Nuk e di sesa afër është, por e di që kur kemi qenë në

16 Likoc ka qenë afër fshatit ..."

17 Edhe fshatin përkthyesi nuk e kapi. A mund ta vazhdoni që

18 prej këtu edhe të shtoni çfarë keni për të shtuar?

19 PË. E di që Likoci ka qenë afër me fshatin Plluzhinë, sepse

20 gjatë atyre ditëve që kemi qëndruar aty derisa ka arrit z.

21 Limaj kemi frekuentu këtë pjesë Likoc, Plluzhinë. Do të thotë

22 kanë qenë afër njëra-tjetrës. Kaq e mbaj mend.

23 PY. Në rregull. Megjithatë, Prekazi në atë kohë ka qenë nën

24 kontrollin e forcave serbe, apo jo, pas masakrës së Jasharëve?

25 PË. Nuk e di. Mund të ketë qenë. Sigurisht që ka qenë.

1 PY. Në rregull. Kur mbërritët në Kleçkë, ju nuk kishit një
2 rol konkret. I keni thënë Prokurorisë që ju thjesht donit që
3 të shpërndanit frymën e UÇK-së në mesin e popullatës. A është
4 e vërtetë kjo, Dëshmitar?

5 PË. Jo vetëm unë se s'kisha rol konkret, por mendoj edhe të
6 tjerët nuk kishin ndonjë rol konkret.

7 PY. Pra, nuk ka pasur role të përcaktuara ndërmjet jush si
8 grup luftëtarësh, kështu?

9 PË. Fillimisht është -- e kemi dit ose e kemi njoft ose si
10 përgjegjës z. Limaj të pikës, dhe në atë periudhë konsideroj
11 se UÇK-ja ka vepru me pika. Mandej edhe detyrat që i kam krye
12 unë dhe dy të tjerë që më kanë ndihmuar apo që i kemi kryer në
13 bashkëveprim nuk është se ka pas ndonjë emërim formal për ato
14 detyra, por thjesht kemi filluar të merremi dhe ashtu kemi
15 vazhduar deri pas ofensivës së parë.

16 PY. Ju keni qenë vullnetar, apo jo, Dëshmitar?

17 PË. Unë mendoj që ka ekzistuar, mund të themi, një ndarje e
18 brendshme me mirëkuptim, ka mund të bëhet një ndarje e punëve
19 brendapërbrenda pikës. Po flas çdo herë brenda pikave. Në këtë
20 rast po foli për pikën e Kleçkës. Nuk e di si kanë funksionu
21 pika të tjera.

22 PY. Po, por në pikën e Kleçkës ju ishit të gjithë vullnetarë
23 që po mundoheshit të bënit më të mirën që ju mundeshit nën
24 grupin tuaj të luftëtarëve. A është ky një vlerësim i drejtë i
25 rolit tuaj, Dëshmitar?

1 PË. Mendoj që të gjithë pjesëtarët e UÇK-së kanë qenë
2 vullnetarë sepse UÇK-ja është kriju me vullnetarë por,
3 sidoqoftë ne përgjegjës e kishim z. Limaj në pikën e Kleçkës
4 dhe si të tillë edhe e respektonim.

5 PY. Edhe z. Limaj vetë ka qenë vullnetar, apo jo, Dëshmitar?

6 PË. Po. Përderisa është kthy nga Zvicra nuk e ka detyru
7 askush, nuk e ka obligu askush. Mirëpo mendoj që ka qenë
8 detyrim ndaj atdheut sepse nuk ka pas detyrim ligjor që të
9 kthehet ai në Kosovë, por ka qenë një detyrim moral, mendoj.
10 Ai, unë dhe të tjerë.

11 PY. Mënyra se si funksionon kjo në praktikë besoj që është
12 shpjeguar në intervistën që i keni dhënë ZPS-së ku shpjegoni
13 se si keni shkuar për të luftuar në Grykën e Llapushnikut.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal referenca për
15 këtë është prova P2006.1, Pjesa 1 e Rishikuar, faqet 15 dhe
16 16.

17 PY. Aty ju thoni që:

18 "Më kujtohet që në Llapushnik ka qenë hera e parë që
19 është bërë -- që kam qenë në Grykën e Llapushnikut. Disa shokë
20 të mi dhe unë shkuam në mënyrë vullnetare për të ndihmuar në
21 luftime, për të ndihmuar ata. Pra, më kujtohet në Llapushnik
22 si edhe fakti që ka pasur një luftim atje."

23 Pra, a e kuptoj drejt unë që kjo është një punë që ju e
24 kuptoni që është bërë prej vullnetarëve? Domethënë që
25 vullnetar do të thotë që ti të shkosh në Kosovë vetë me

1 vullnetin tënd pa ja u kërkuar njeri tjetër këtë gjë?

2 PË. Po siç e thashë ka qenë obligim moral i ynë që të
3 kthehemi në Kosovë dhe të bëjmë më të mirën për vendin tonë.
4 Sa i përket betejës së Llapushnikut duhet të ketë qenë dita
5 dhe ku është e nxënë për herë të parë Gryka e Llapushnikut,
6 magjistranja që është blloku dhe ka qëndruar përreth dy-tre
7 muaj ndoshta, dy muaj e gjys ka qëndruar e bllokuar deri në
8 ofensivën serbe.

9 Sa i përket pikave që mendoj në atë periudhë kanë
10 funksionu të pavarura njëra me tjetrën, do të thotë nuk janë
11 subordinu pika pikës. Kudo që ka pas luftime e kemi ndihmu
12 pika pikën sepse në fund të fundit kemi pas të njëjtin armik.

13 PY. Ju keni shkuar për të ndihmuar grupe të tjera ose njësi
14 të tjera, po këtë e keni bërë si vullnetar, domethënë me
15 dëshirën tuaj personale nuk është se jua kërkuar njeri. Këtë e
16 keni bërë vullnetarisht, apo jo, Dëshmitar?

17 PË. E saktë, e saktë.

18 PY. I keni thënë Prokurorisë - përsëri nuk do lexoj të gjithë
19 referencën, megjithatë për procesverbal është prova P2006.1,
20 Pjesa 1, faqja 21 - që ju u pyetët sesa persona kanë qenë duke
21 luftuar në grupin tuaj. Kjo ka qenë gjatë ofensivës së verës.
22 Domethënë, pyetja që ju bëhet është sa persona kanë qenë duke
23 luftuar. Dhe ju thoni:

24 "Mbase mund ta kem gabim, por nuk e di ekzaktësisht sa
25 kanë qenë. Por mund të kenë qenë ndoshta 20, 30, 40 persona.

1 Nuk jam i sigurt. Nuk e di."

2 Me aq sa ju kujtohet juve, në thelb ju po flisni për
3 periudhën deri në qershor '98-s dhe po flisni këtu për numrin
4 e përgjithshëm të luftëtarëve, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Çdo herë po i referohem pikë së Kleçkës, do të thotë i
6 jam referu pikës së Kleçkës.

7 PY. Deri në qershor të 1998-s ose korrik '98-s përpara
8 ofensivës së verës, e kam fjalën për kohën. Domethënë, e keni
9 fjalën deri për qershorin, korrik '98-s përpara ofensivës,
10 kështu?

11 PË. Deri në fillimin e ofensivës.

12 PY. I keni thënë po ashtu ZPS-së që jeni informuar për
13 mbërritjen e oficerëve profesionistë të ushtrisë që kanë
14 mbërritur në qershor të '98-s, duke përfshirë Agim Çekun,
15 Bislim Zyrapin dhe Naim Miftarin -- Naim Malokun, më falni. A
16 ja -- a ju kujtohet që t'ja keni thënë ZPS-së këtë? Dhe ju
17 keni thënë që këta persona keni parë në Kleçkë, po ata kanë
18 qenë të pozicionuar në të gjithë Kosovën ndërkohë.

19 PË. Por ka pas edhe eprorë të tjerë, jo të gjithë m'u kanë
20 kujtuar, mirëpo që ata pastaj kanë lëvizur. Por nuk e di saktë
21 ku dhe si kanë lëvizur ata.

22 PY. Ata janë mirëpritur në Kosovë nga personat të ngjashëm si
23 puna juaj dhe kolegët tuaj për shkak të ndihmës që ata mund të
24 jepnin për grupet tuaja të luftëtarëve. A do ishte një
25 përshkrim i saktë ky?

1 PË. Po, i saktë.

2 PY. Megjithatë, pavarësisht rolit dhe ndihmës së tyre, forcat
3 serbe kishin shumë herë më tepër forca, mjete ushtarake dhe
4 persona që luftonin kundër jush në Kosovë në atë kohë? Pra,
5 domethënë kishte -- nuk kishit forca të barabarta, në kuptimin
6 që serbët kishin shumë herë më tepër pajisje, njerëz më shumë
7 sesa juve, kështu?

8 PË. Mendoj niveli i forcave ka qenë i pakrahasueshëm, do të
9 thotë atë që ju e përshkruani.

10 PY. Gjatë ofensivës së verës, e kam fjalën këtu për korrikun,
11 gushtin e 1998-s, forcat dhe armatimet e rënda që i kishin në
12 dispozicion forcat serbe në zonë i kanë shkatërruar njësitë
13 ose grupet të cilat ishin në funksionim tek ju. A është e
14 saktë kjo?

15 PË. Po, e saktë.

16 PY. Dhe ky shkatërrim do të thonte që askush nuk mund të
17 jepte dot as urdhra as udhëzime për askënd sa i takon njërive
18 të luftimeve dhe referenca për këtë është intervista që i keni
19 dhënë ZPS-së Pjesa 1, faqja 26.

20 PË. E saktë.

21 PY. Gjithashtu, në të njëjtën kohë ju nuk komunikoni dot me
22 njësinë tuaj në Kleçkë. Ju në këtë kohë keni qenë në Arllat,
23 në mos e kam gabim, kështu?

24 PË. Fillimisht në Arllat pastaj në Tërpezë ku dhe kam mbetur
25 për një kohë të caktuar deri pas ofensivës së parë,

1 përkatësisht, pasi ka fillu ristrukturimi i UÇK-së deri kah
2 fundi i fundit nëntor '98, kam qenë në Tërpezë. Në fakt në
3 komandën e batalionit fillimisht kur u formu në Tërpezë,
4 pastaj kemi ndërru shtëpi dhe prapë kam vazhduar në Tërpezë
5 për në një objekt tjetër së bashku me Bajram Gashin dhe disa
6 motra medicinale.

7 PË. Por, është e drejtë të thuhet, apo jo, që përpara kësaj
8 pike gjatë ofensivës serbe vijimësia e UÇK-së si forcë
9 luftuese, në qoftë se mund të shprehesha kështu, ishte në
10 pikëpyetje në atë kohë, apo jo?

11 PË. E saktë.

12 PY. Pra, kishte luftëtarë që ishin kthyer prej shteteve të
13 tjera jashtë Kosovës ose kishte dhe shumë persona të tjerë të
14 cilët ishin të dëmtuar ose të plagosur gjatë asaj kohe. A
15 është një përshkrim i saktë i situatës ky?

16 PË. I saktë është.

17 PY. Pra, gjithçka që mund të bënit në atë kohë ishte që të
18 përpiqeshit që të mbijetonit edhe të rigrupoheshit, apo jo?

19 PË. Pikërisht.

20 PY. Kur po e përmendnit përpara këtë domethënë ristrukturimin,
21 a është e drejtë që të thuhet që e vërteta ishte që ju përsëri
22 po fillonit nga zeroja, domethënë po e fillonit të gjithën nga
23 zeroja përsëri?

24 PË. Prandaj e kam thënë javën e kaluar tek znj. Prokurore që
25 ndoshta më i drejtë është termi rikonstruktim sesa

1 ristrukturim, sepse rikonstruktim mendoj se nënkuptoj
2 ndërtimin e diçkaje nga fillimi.

3 PY. Pra, ishte vetëm thjesht një themel por jo më shumë sesa
4 kaq. Domethënë e vërteta është që nuk është se po
5 riorganizonit diçka që kishte ekzistuar më përpara, por
6 përsëri po e nisnit çdo gjë nga zeroja, a është kështu?

7 PË. Ofensiva e vitit '98 e ka sjellë UÇK-në në një gjendje më
8 keq se ç'ishte me pika ose me ç'funksiononte me pika. Do të
9 thotë pikërisht e ka kthyer në pikën zero.

10 PY. Sa i takon kohës se sa shpejt ju mund ta zhvillonit ose
11 mund ta përfundonit rikonstruktimin e UÇK-së pa diskutim që
12 kjo do ishte diçka që do merrte disa muaj domethënë nuk mund
13 të ishte diçka që mund të bëhej brenda natës, apo jo?

14 PË. Po prandaj në intervistimin e vitit 2019 i kam thënë
15 Prokurorit të Specializuar se në një pyetje ku i referohet
16 Prokurori pas ristrukturimit, i kam thënë se nuk ka periudhë
17 pas ristrukturimit se ristruktimi s'ka përfunduar asnjëherë. Ai
18 ka vazhdu në vazhdimësi për këtë duke u përpjekur me i
19 konsolidu radhët dhe strukturën e funksionimit të UÇK-së.

20 PY. Pra, një brigadë formale mund të njoftohej formalisht se
21 ekzistonte, megjithatë në atë kohë nuk besoj që kanë ekzistuar
22 numri i duhur ose numri minimal i ushtarëve që nevojiteshin në
23 mënyrë të tillë që të krijohej një brigadë. A është kështu?

24 PË. Unë nuk e di në aspektin ushtarak se çfarë numri duhet të
25 plotëson një brigadë, po unë e di se Brigada 121 gradualisht

1 në kuadër të saj ka pasur ose ka krijuar rreth 1300 maksimumi
2 deri në 1500 ushtarë. Gjithmonë shifrat ose numri i ushtarëve
3 ka variu. Nuk ka qenë një numër fiks dhe ka lëviz nga dita në
4 ditë. Por gjithsesi mbi 1000 ka qenë. Do të thotë deri në
5 fazat e mëvonshme është arrit ky numri, jo fillimisht.
6 Fillimisht sigurisht që ka qenë numër më i vogël.
7 PY. Tani do të kalojmë në një temë tjetër që kanë të bëjë me
8 marrëdhënien që keni patur ju me Sokol Dobrunën dhe gjykatën
9 ushtarake. Do t'ju pyes gjithashtu edhe lidhur me procedurat
10 dhe proceset që zbatoheshin nga gjykata ushtarake.

11 A është e drejtë të thuhet që ju keni pasur kontaktet ose
12 marrëdhënie të vazhdueshme me Sokol Dobrunën që prej dhjetorit
13 1998 e në vijim deri nga fundi i luftës apo fillimi i
14 qershorit, mesi i qershorit më saktë?

15 PË. Po, fillimi i kontakteve me z. Dobruna është bërë shkak
16 rasti i Driton Gashit. Aty ka fillu njohja, takimi edhe
17 bashkëpunimi me z. Dobruna, për të cilin kam pas mandej edhe
18 pëlqimin e z. Shala, të komandantit të brigadës. Dhe natyrisht
19 që duke qenë ai profesionist i fushës, na ka udhëzuar
20 saktësisht se si duhet të veprojmë dhe si duhet të sillemi, do
21 të thotë lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë tona.

22 PY. Ai besoj që ju ka dhënë shumë udhëzime me gojë, me
23 shkrim, verbale, të paktën kjo është mënyrë që ja u keni
24 shpjeguar kontaktet midis dhe atij ZPS-së. A është e vërtetë,
25 a është e saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Udhëzime gjithmonë janë dhënë ose janë pranuar në mënyrë
2 verbale, mirëpo në fazën fillestare kam mbajtur edhe shënime,
3 kam mbajtur edhe shënime nga ajo që ai ka diktu në mënyrë
4 verbale. Për shembull, i kam qujt unë herët, në intervistimin
5 e mëhershëm sepse ashtu ka qenë, formë shablloni se si duhet
6 të hartohet një kallëzim penal, një procesverbal, një
7 deklaratë, e të tjera.

8 PË. Ju nuk është se keni pas ndonjë marrëdhënie konkrete ose
9 specifike sa i takon strukturës organizative të UÇK-së. Këtë
10 të paktën ja keni thënë në intervistën tuaj ZPS-së, në Pjesën
11 3 të intervistës, në faqen 13 dhe 14; domethënë me fjalë të
12 tjera ju nuk është se keni pasur marrëdhënie zyrtare ose
13 formale me të. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Me z. Dobruna fillimi i kontakteve, i takimeve ka qenë i
15 rastësishëm. Mirëpo, vazhdimi i mëtutjeshëm i takimeve mendoj
16 se ka pas karakter formal. Nga vetë fakti sepse të përgatitet
17 një lëndë, një kallëzim penal dhe të bëhet pranim dorëzimi me
18 nënshkrime të dyanshme kjo i takon sferës formale, do të duhej
19 t'i takonte sferës formale.

20 PY. Po. Ai ishte jurist me përvojë, i kualifikuar në atë
21 kohë, apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. Ndërsa ju nuk keni qenë jurist në atë kohë, kështu që
24 është e drejtë të thuhet që ju ishit i shqetësuar për mungesën
25 e eksperiencës, përvojës profesionale. A është e drejtë kjo,

1 Dëshmitar?

2 PË. E drejtë dhe e saktë.

3 PY. Ju keni treguar një lloj niveli admirimi lidhur me atë se
4 çfarë ju ka treguar z. Dobruna, apo jo?

5 PË. Po sigurisht sepse po të mos ishte ai, nuk e di se si do
6 të vepronim. Nuk mund ta imagjinoj mandej pjesën tjetër.

7 PY. Mendoj që në seancën përgatitore në paragrafin 16 -- 60,
8 ju e përshkruani marrëdhënien me z. Dobruna në mënyrën e
9 mëposhtme. Do t'jua lexoj:

10 "Ajo çfarë ishte e rëndësishme për ju në atë kohë
11 domethënë për ju, për numrin, Dëshmitarin 04743, që t'ja bënit
12 të qartë z. Dobruna që nuk kishit njohuri për ligjin dhe për
13 ju Dobruna ishte ligji. Domethënë, për ju Dobruna ishte
14 ligji."

15 A është një vlerësim i drejtë i marrëdhënies që kishit ju
16 me atë në atë kohë?

17 PË. Po përderisa ne nuk kemi posedu asnjë kod penal ushtarak
18 ose kod të procedurës penale ushtarake ose udhëzime të
19 shkruara, në këtë kontekst kam thënë se Sokol Dobruna për mua
20 ishte ligji. Prandaj iu kam referu si të tillë.

21 PY. Ju mbështeteshit shumë tek ajo çfarë ju thoshte ai lidhur
22 me ligjin, me përmbajtjen e ligjit, si sa i takon procedurës
23 po edhe përmbajtjen tij, apo jo?

24 PË. Po për derisa nuk kishim ku të bazohemi diku tjetër, siç
25 e thashë më parë, ne nuk e kishim një ligj në duart tona të

1 cilit mund t'i referoheshim, andaj do të duhej t'i
2 referoheshim gjithqysh udhëzimeve të z. Sokol Dobruna, sepse
3 udhëzimet e tij nuk kanë qenë të karakterit dëshiror. Mirëpo,
4 është çështje edhe e personalitetit të individit sepse e kam
5 dashtë rregullin si të tillë. Gjithmonë kam dashtë këtë
6 rregull dhe disiplinë.

7 PY. Z. Dobruna ju është prezantuar juve si kryetari i
8 gjykatës ushtarake, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Po, saktë.

10 PY. Mesa keni dijeni ju, Shtabi i Përgjithshëm ka qenë
11 gjithmonë mbështetës për ekzistencën e një gjykate ushtarake,
12 apo jo, Dëshmitar?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtojmë. Cila është baza?

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është një pyetje, të nderuar
15 Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
17 përgjigjeni pyetjes, Dëshmitar. Rrëzohet kundërshtimi i
18 Prokurorisë.

19 DËSHMITARI: Ka mundësi ta përsëritni pyetjen, ju lutem?

20 Z. ROBERTS: [Përkthim]

21 PY. Mesa keni njohuri ju, Shtabi i Përgjithshëm gjithmonë e
22 ka mbështetur ekzistencën e gjykatës ushtarake. A është
23 kështu?

24 PË. Unë mund të them që gjykatën ushtarake duhet ta ketë
25 krijuar Sokol Dobruna me autorizimet që ka marrë nga Shtabi i

1 Përgjithshëm apo nga komandanti i përgjithshëm, mirëpo nuk
2 mund t'i di këto procedura me saktësi sepse është një sferë të
3 cilët nuk i kam takuar dhe mund t'ja jap përgjigje supozuese
4 më tepër.

5 PY. Por, ju vetë gjatë bisedave me z. Dobruna, ai vetë ju ka
6 thënë ndonjëherë që s'ka mbështetje për këtë gjë?

7 PË. Nuk mbaj mend të më ketë thënë, por nuk më kujtohet diçka
8 e tillë.

9 PY. Vetë z. Dobruna nuk ka qenë pjesëtar i Shtabit të
10 Përgjithshëm, apo jo?

11 PË. Nuk e di.

12 PY. Kur keni përmendur gjykatën ushtarake, në terma të
13 përgjithshme, a është e drejtë të themi që në fakt kur keni
14 thënë gjykatë ushtarake ju keni pasur në mendje z. Sokol
15 Dobruna? Pra, a ishte sipas jush ai përfaqësuesi i gjykatës
16 ushtarake apo vetë gjykata ushtarake?

17 PË. Sipas asaj që ma ka thënë z. Dobruna, ai ka qenë shef i
18 shërbimeve juridike pranë komandantit të Shtabit të
19 Përgjithshëm, i cili ka pasur kompetenca apo autorizime që ta
20 themelojë gjykatën, prokurorinë dhe qendrën e mbajtjes. Do të
21 thotë, Sokol Dobruna njëkohësisht edhe kryetari i gjykatës
22 ushtarake. Tash nga ajo që prapë sipas sqarimeve që mi ka bërë
23 ai sepse kemi punuar së bashku disa muaj, e ka thënë se "kjo
24 është nivel i gjykatës ushtarake nivel qendror". Dhe referuar
25 kësaj, do të thotë kam tërhek atë paralele se gjykata

1 ushtarake i ka takuar nivelit qendror dhe kam këtë bindje edhe
2 sot në këtë sallë gjyqi.

3 PY. Që të jemi të qartë, ju në bazë të asaj që ka thënë z.
4 Dobruna keni kuptuar që ai duke qenë shefi i shërbimit juridik
5 kishte dhe kompetencën ta krijonte gjykatën.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtoj, është shtrembëruar
7 dëshmia.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

9 Mund të përgjigjeni, Dëshmitar.

10 DËSHMITARI: Jo kishte kompetencën me themelu, por në
11 momentin kur unë e kam taku z. Dobruna ai veç kishte qenë
12 kryetari i gjykatës ushtarake. Së paku ashtu është deklaruar.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim]

14 PY. Dhe si kryetar i gjykatës ushtarake ai ishte dhe personi
15 që përgatiti procedurat për gjykatën ushtarake dhe
16 juridiksionin, apo jo?

17 PË. Nuk mund t'i di ato pjesë të procedurave të tjera, se si
18 është krijuar apo e ka krijuar gjykatën ushtarake.

19 PY. A mund të themi se ai ka qenë i pavarur, goxha i pavarur
20 në ushtrimin e rolit të tij si kryetar i Gjykatës ushtarake.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtoj. Ku bazohet kjo?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

23 Dëshmitar, mund t'i përgjigjeni.

24 DËSHMITARI: Nuk e di.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim]

1 PY. A nuk ju ka thënë ndonjëherë ai ju në takimet e shumta që
2 keni se sa e rëndësishme ishte për të që të ishte i pavarur i
3 Shtabi i Përgjithshëm dhe për mënyrën se si duhet të
4 funksiononte gjykata ushtarake në mënyrë të pavarur?

5 PË. Nëse flasim për nocionin e gjykatave në përgjithësi,
6 natyrshëm ato duhet të jenë të pavarur. Por, unë kur kam thënë
7 atëherë dhe sot, ka qenë gjykatë ushtarake e nivelit qendror.
8 Se sa ka qenë ai i pavarur apo i varura, këtë e din vetëm ai
9 dhe sigurisht Shtabi i Përgjithshëm.

10 PY. Z. Dobruna a ua ka thënë ndonjëherë ju që kishte
11 përpiluar kornizën ligjore Gjykatën ushtarake. Ua ka thënë
12 këtë gjë?

13 PË. Ajo që mbaj mend gjatë takimeve të herëpashershme apo dhe
14 të shpeshta, e mbaj mend që ka qenë duke punuar në atë
15 kornizë. Do të thotë e kam fjalën për kodin penal ushtarak dhe
16 kodin e procedurës penale, të cilin asnjëherë nuk e kam pa ose
17 nuk e kam pas në dorë atë kod. Për diçka tjetër nuk jam në
18 dijeni.

19 PY. Por ju mbështeteshit në fjalën e tij kur ju ka thënë se
20 një person mund të ndalohej dhe të mbahej i ndaluar për një
21 periudhë maksimale prej 72 orësh. Pra, këtë e keni bërë në
22 bazë të fjalës së z. Dobruna, apo jo?

23 PË. E saktë.

24 PY. Dhe ju në fakt nuk kishit ndonjë alternativë tjetër
25 përveçse të mbështeteshit në fjalën e z. Dobruna, apo jo?

1 PË. Besoj që e thashë dhe më herët se nuk kishim se ku të
2 mbështeteshim diku tjetër.

3 PY. Z. Dobruna këtë këshillë ua jepte të gjithë personave që
4 kishin rol të ngjashëm me tuajin, të paktën me sa keni ju
5 dijeni?

6 PË. Nuk e di.

7 PY. Mesa dini ju, ka pasur ndonjë person tjetër përgjegjës
8 për hartimin e dokumentacionit apo rregullore të gjykatës
9 ushtarake? Mesa keni dijeni.

10 PË. Nuk mund të them për person përgjegjës, po e di që vinin
11 edhe ndonjë avokat nga Prishtina për ta ndihmuar procesin,
12 sepse një nga ata kam pas rastin ta njof edhe ta takoj.

13 PY. Kush është ky person?

14 PË. Ai ka qenë z. Bajram Krasniqi, që tani është i ndjerë.

15 PY. Dhe mesa keni kuptuar ju, ky person ka ndihmuar, ka
16 këshilluar z. Dobruna? Këtë po thoni?

17 PË. Jo, për aq sa kam arrit ta kuptoj, ai e ka ndihmuar në
18 atë kornizën ligjore që po e quani ju, po konkretisht dhe
19 saktësisht se ç'ka kanë arritur të kryjnë, nuk e di. E di që
20 po angazhohej në atë drejtim, por nuk di nëse kanë finalizuar
21 diçka apo jo.

22 PY. Pra, z. Krasniqi, mesa keni kuptuar ka punuar nën
23 udhëzimet e z. Dobruna, ç'ka do të thotë që fjalën e fundit e
24 kishte z. Dobruna, sa i takon procedurave, apo jo?

25 PË. Po nëse bazohemi në procedura, do të duhej të ishte

1 ashtu, por, se si kanë ndërvepruar ata këtë s'mund ta them me
2 kompetencë.

3 PY. Sistemi që krijoi z. Dobruna, si kryetar i gjykatës,
4 sigurisht që varej nga hetimet dhe bashkëpunimi në nivel të
5 brigadave -- në nivel të zonës, nga brigadat në nivel zone,
6 kështu?

7 PË. Po nuk e di se çfarë bashkëpunimi ka pas dhe ka arrit të
8 krijojë z. Dobruna me zonat dhe me brigada të tjera. Krejt atë
9 që kam dëshmuar dhe jam në gjendje ta dëshmoj relacionin e
10 brigadës, përkatësisht policisë së brigadës me z. Dobruna.
11 Mirëpo, në relacion me zonat të tjera dhe brigada të tjera
12 nuk, nuk mund të them asgjë.

13 PY. Keni të drejtë. Po të paktën në zonën tuaj, në brigadën
14 tuaj, domethënë, z. Dobruna, priste nga hetimet tuaja dhe nga
15 hetimet të çonit ju rastet tek ai. Ai nuk kishte ndonjë
16 kompetencë apo ndonjë autoritet të pavarur që ta çelte ai një
17 hetim?

18 PË. Nëse mund t'i referohemi dhe të thirremi në autoritetin e
19 tij, kemi së paku një rast ku me urdhër të tij është bërë
20 ndalimi i personit.

21 PY. Po, por, për shembull, hetimin e një rasti, sistemi ishte
22 i atillë që ai priste t'ja çonit ju rastet, çështjet pasi të
23 kryenit hetime?

24 PË. Në qoftë se mendoni për hetime të mirëfillta qysh ndodhin
25 në kohë paqe, ato nuk kanë mundur të zhvillohen si të tilla.

1 Ne mund t'i referohemi më në raste dhe katër të nënshkruara na
2 unë dhe dy që i kam përgatitur së bashku me z. Nexhmi
3 Krasniqi, për afërsisht do të thotë janë gjashtë, shtatë me të
4 cilat jemi marrë dhe nuk bëhet fjalë për dhjetëra apo qindra
5 sepse ky funksionim ka ndodhur për rreth pesë-gjashtë muaj dhe
6 s'ka zgjat lufta më tepër.

7 Përveç asaj bëhet fjalë, qysh e thashë, për gjashtë-
8 shtatë raste dhe nuk kanë qenë prioritet rastet kur ka pas
9 luftime. Do të thotë çështja e rasteve ka qenë çështje
10 dytësore, jo çështje parësore. Prioritet, edhe një herë po e
11 theksoj, kanë qenë vijat e frontit dhe lufta me forcat serbe.
12 Prandaj nuk ka raste shumë sepse kanë munguar edhe kushtet
13 edhe resurset edhe të gjitha.

14 Për shembull, në brigadë që iu referut hetimeve, i kemi
15 pas gjithsej 20 policë ushtarë. Dhe imagjinoi një territor i
16 thyeshëm me gjithë ato male, ato bjeshkë i cili është shtri në
17 katër, pesë komuna, të mund të ushtrohet një kontroll efektiv,
18 cep më cep atij territori. Ç'ka mundesh me bo me 20 policë
19 ushtarë kur kanë mungu edhe kualifikimet përkatëse.

20 Do të thotë për ta kuptu të vërtetën e funksionimit në
21 ato rrethana, do të duhej të analizohet dhe të shiqohet secili
22 nga këto raste dhe atëherë mund të kuptohet. Por nuk mund të
23 flasim për hetime dhe për raste të hartuara në mënyrë
24 standarde, sepse nuk kanë leju kushtet dhe rrethanat e luftës.
25 PY. Po. Ka kufizime në rrethana të tilla që rrjedhimisht kanë

1 pasur ndikim në punën tuaj edhe në punën e Gjykatës, apo jo?

2 PË. Po tash, e kam thënë edhe më herët, për aq sa unë e kam
3 ditë, ka qenë vetëm një gjyqtar dhe ai ka qenë z. Dobruna. Unë
4 nuk di që ka pas një gjyqtar të dytë, sikurse edhe për një
5 prokuror të dytë.

6 PY. Po. Dhe z. Dobruna ka qenë ai që emëroi prokurorin që
7 punonte në gjykatë, dhe më duket se ka pas vetëm një prokuror,
8 apo jo?

9 PË. E thashë që ka qenë vetëm një prokuror, sipas asaj që unë
10 e di, mirëpo, nuk e di se kush e ka emëruar, kush ka bërë
11 emërimin e tij.

12 PY. Por, nëse do të -- nëse nuk do të ishte z. Dobruna i
13 pranishëm për arsyet e veta, atëherë nuk do të funksiononte
14 gjykata, apo jo?

15 PË. Po neve na ka ndodh së paku në dy-tri raste të mos e
16 gjenim z. Dobruna, dhe kurdo që nuk e kemi gjetur z. Dobruna,
17 kallëzimet penale ja kemi dorëzuar prokurorit ushtarak,
18 pavarësisht si rregull që në teori e dimë tash, se atëherë nuk
19 e kam dit, që kallëzimet penale duhet të dorëzohen tek
20 prokurori ose në prokurori, ne i kemi dorëzuar tek gjyqtari
21 apo në gjykatën ushtarake. Kryesisht, pjesën dërrmuese.

22 Çfarë dua të them me këtë, sepse nuk ka ekzistuar një
23 procedurë standarde. Ka qenë e pamundur të zbatohet një
24 procedurë standarde, prandaj e kam theksuar e ritheksuar se
25 secili rast e ka specifikat e veta.

1 PY. A mund të themi që mungesa e një procedure pune standarde
2 ishte për faktin se z. Dobruna juve nuk ju kishte dhënë
3 dokumentacionin që ju nevojitej?

4 PË. Në radhë të parë, nuk e di a ka posedu z. Dobruna, a ka
5 arrit dhe kur ka arrit ta përfundojë, nuk e di saktësisht atë
6 pjesë. Në anën tjetër nuk do të thotë që edhe po të arrinte të
7 na dorëzonte atë dokumentacion, nuk ishim të përgatitur, të
8 trajnuar edhe që ta kuptonim me start, me fillim në momentin e
9 pranimit të atij dokumentacioni. Sidoqoftë, unë nuk e kam
10 posedu atë lloj dokumentacioni dhe as vartësit e mi.

11 PY. Pak më -- pak më përpara thatë -- duhet ta gjejmë në
12 transkript, por thatë kur ka pasur luftime, sigurisht që
13 hetimi i rasteve nuk ishte prioritet. Po përdor unë formulimin
14 tim. Kështu?

15 PË. Nuk -- çështja e hetimit nuk ka qenë çështje permanente.
16 Gjithsesi ajo që ju e thatë, sepse e kam unë thënë edhe më
17 herët, kur ka pas luftime asgjë tjetër nuk ka pas prioritet.
18 Mirëpo, edhe kur nuk ka pas luftime, s'do të thotë që në
19 momentin që hetimet e luftimet kanë pushu, nuk do të thotë që
20 menjëherë janë aktivizu hetimet aty, sepse kemi pas detyra të
21 tjera. Kemi pas detyra të tjera dhe nuk kanë mund të
22 zhvillohen hetime të rregullta dhe permanente. Janë zhvilluar
23 ato që janë zhvilluar dhe që mendoj i keni para vetes. Do të
24 thotë ajo ka qenë e mundur të bëhet dhe është bërë,
25 pavarësisht a është bërë në mënyrën e duhur apo jo,

1 pavarësisht a është bërë në mënyrën profesionale apo jo. Ajo
2 punë që është bërë është e prezantuar këtu.

3 PY. Pra, ju po bënit më të mirën e mundshme në rrethanat e
4 asokohe kohe, apo jo?

5 PË. Besoj që po.

6 PY. Dhe sigurisht vendi ku qëndronit ju, Brigada 121 në zonën
7 e Kleçkës, ka qenë edhe qendra e sulmeve prej forcave serbe në
8 periudhën e prillit dhe majit të '99-s, apo jo?

9 PË. E di që e kanë sulmuar një herë me aeroplan me MiG-29,
10 kujtoj. Por nëse i referoheni qendra, natyrisht sepse në
11 Kleçkë ishte komanda e brigadës dhe rreth Kleçkës aty në
12 Divjakë ishte selia e Shtabit të Përgjithshëm, në Fshat të Ri
13 më vonë ishte selia e Qeverisë së Përkohshme, në Berishë ishte
14 Kosova e Lirë. Praktikisht të gjitha ato mekanizma ashtu çfarë
15 ishin ndodheshin në atë bjeshkë dhe qëllimi i forcave serbe
16 ishte ta pushtonte atë pjesë gjatë ofensivës së fundit, dhe
17 sigurisht që do t'i sillte vështirësi funksionimit të UÇK-së.

18 PY. Kur thoni "UÇK-së", ju e keni fjalën për aftësinë apo
19 mundësinë tuaj për të kryer hetime dhe mundësinë e gjykatës
20 për të gjykuar rastet që do t'i çonit ju?

21 PË. Jo, jo, unë e pata parasysh përgjithësi funksionimin e
22 UÇK-së, sepse rastet që janë hap ose i ka inicju dikush jemi
23 mundu t'i trajtojmë aq sa kemi pas hapësirë, mundësi dhe
24 kapacitet. Duke theksuar apo ritheksuar edhe një herë se bëhet
25 fjalë për rreth shtatë, tetë raste, apo në tërësi nëntë raste.

1 Dhe asnjë rast më tepër.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shikoj kohën.

3 PY. Faleminderit, z. Krasniqi. Do shihemi përsëri bashkë
4 nesër në mëngjes.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi
6 përfunduar me dëshminë tuaj sot, z. Krasniqi. Ju lutem mos
7 flisni me askënd lidhur me dëshminë tuaj gjatë natës. Do
8 shikohemi përsëri nesër në mëngjes në orën 9.00.

9 DËSHMITARI: Në rregull.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 --- Seanca mbyllet në orën 16.31

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25